Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

**Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO**

# Programi i Bashkëpunimit Zviceran **Shqipëri** 2022–2025



# Tabela e përmbajtjes

**Parathënie**

**1. Konteksti i vendit** **7**

**2. Objektivat e politikës së jashtme zvicerane për Shqipërinë dhe kontributi nga partnerë të tjerë për zhvillim** **12**

**3. Rezultatet e Zvicrës për periudhën 2018-2021** **14**

3.1 Qeverisja demokratike **14**

3.2 Zhvillimi ekonomik dhe punësimi **15**

3.3 Infrastruktura urbane dhe energjia **16**

3.4 Shëndetësia **16**

**4. Implikimet për Programin e Bashkëpunimit 2022-2025** **17**

**5. Orientimi strategjik dhe prioritetet zvicerane për 2022-2025** **18**

5.1 Qeverisje demokratike **18**

5.2 Zhvillimi ekonomik dhe punësimi **19**

5.3 Shërbimet infrastrukturore dhe ndryshimet klimatike **20**

5.4 Shëndetësia **21**

5.5 Tema tej-përshkuese **22**

**6. Menaxhimi i zbatimit të programit të bashkëpunimit** **23**

**7. Drejtimi strategjik i programit të bashkëpunimit** **24**

Shtojca 1: Përmbledhje e kuadrit të rezultateve **25**

Shtojca 2: Kuadri i rezultateve për portofolin zviceran **27**

Shtojca 3: Sistemi i monitorimit **38**

Shtojca 4: Planifikimi financiar (në CHF) **39**

Shtojca 5: Shkurtesat **40**

Shtojca 6: Harta me 12 qarqet e Shqipërisë **42**

# Parathënie

Qëndrueshmëria dhe begatia e rajonit të Ballkanit Perëndimor mbetet një prej qëllimeve strategjike të politikës së jashtme zvicerane. Angazhimi i Zvicrës në këtë rajon u intensifikua në vitet 1990 me ofrimin e ndihmës humanitare dhe paqeruajtëse, si dhe strehimin e shumë personave të prekur nga konflikti i armatosur. Që atëherë, Zvicra dhe Ballkani Perëndimor kanë zhvilluar lidhje të ngushta , sikurse dokumentohet nga bashkëpunimi i ngushtë dhe diaspora e konsiderueshme që jeton në Zvicër. Mbi 500,000 shtetas zviceranë kanë lidhje familjare me Ballkanin Perëndimor.

Zvicra e ka mbështetur tranzicionin politik, social dhe ekonomik të Shqipërisë që prej vitit 1992; marrëdhëniet diplomatike janë vendosur që në 1970-n. Sot, Zvicra renditet si një nga partnerët më të mëdhenj të bashkëpunimit dypalësh me Shqipërinë. Ky partneritet mirëbesimi ka në themel të tij marrëveshjet dypalëshe midis qeverisë zvicerane dhe asaj shqiptare në fusha të ndryshme si tregti, bashkëpunim ekonomik, mbrojtje investimesh dhe sigurime sociale.

Shqipëria ka shënuar progres të konsiderueshëm politik dhe ekonomik që prej rënies së komunizmit në 1991-shin. Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2002-2025 shpreh përkushtimin e Zvicrës për të vijuar mbështetjen e Shqipërisë në trajtimin e sfidave të mbetura lidhur me ndërtimin e shtetit demokratik, zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbatimin e reformave përkatëse.

Programi i ri për bashkëpunim përqendrohet në katër fusha: qeverisje demokratike, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe punësim, shërbime infrastrukturore dhe ndryshime klimatike, dhe shëndetësi. Zvicra ka ekspertizë të vlefshme në këto fusha dhe mund të japë kontribut efikas dhe të orientuar drejt rezultateve për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë. Angazhimi financiar i parashikuar për periudhën 2022-2025 është 105 milion franga zvicerane në formë grantesh.

Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2022-2025 është hartuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) në konsultim të ngushtë me autoritetet kombëtare, partnerët nga shoqëria civile, sektorin privat, rininë dhe partnerët e tjerë të zhvillimit.

Ne besojmë se qëllimet dhe prioritetet e shprehura në Programin e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2022-2025 kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë, zbatimin e reformave në të mirë të qytetarëve shqiptarë dhe sektorit privat, si dhe për progresin e Shqipërisë në arritjen dhe përmbushjen e standardeve dhe vlerave evropiane.

Bernë, janar 2022

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim (SDC)

Patricia Danzi
Drejtore e Përgjithshme

Sekretariati Zviceran i Shtetit
për Çështjet Ekonomike (SECO)

Marie-Gabrielle Ineichen-Fleisch
Sekretare e Shtetit



# 1. Konteksti i vendit

## Rrugëtimi i Shqipërisë drejt reformës

Në 1991-shin, Shqipëria nisi tranzicionin drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Gjatë këtij procesi, shumë qytetarë emigruan drejt vendeve evropiane, SHBA-ve dhe rajoneve të tjera. Ndonëse disa emigrantë u kthyen për ta ndërtuar jetën në Shqipëri dhe kontribuar në zhvillimin e vendit, numri i tyre ishte i ulët, ndërsa emigracioni pa kthim mbetet ende i lartë, veçanërisht te të rinjtë.

Gjatë 30 viteve të fundit, Shqipëria ka shënuar progres mbresëlënës në ndërtimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë, ka ndërmarrë reforma të rëndësishme, arriti anëtarësimin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe statusin e vendit kandidat për në BE, dhe ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët në rajon. Për më tepër, bashkësitë fetare në vend jetojnë në harmoni. Megjithatë, përpjekjet për të trajtuar të shkuarën shtypëse të regjimit komunist në Shqipëri nuk janë të plota, dhe vendi duhet ende të njohë dhe identifikojë viktimat. Goditja e dyfishtë e tërmetit shkatërrimtar të nëntorit të 2019-s dhe pandemia e COVID-19, nxorën në pah dobësi të administratës publike dhe qeverisjes, krahas nevojës për të rindërtuar më mirë . Dy krizat e njëpasnjëshme zbuluan edhe pikat e forta mbi të cilat mund të ndërtohet, veçanërisht solidaritetin e popullsisë, angazhimin e fortë të bashkive dhe agjentët e ndryshimit në institucione.

## Procesi i anëtarësimit në BE

Shqipëria dhe BE-ja priten **të çelin bisedimet për pranimin** në vitin 2022 ose pak pas këtij viti. Ndonëse progresi i reformës mund të jetë i ngadaltë dhe mund të pengohet nga interesa të ngushta, ndryshimet si pasojë e saj do të jenë afatgjata. Skenari më optimist e parashikon Shqipërinë si vend anëtar të BE-së në 2030-n, ose pak pas këtij viti, sidomos nëse BE-ja i kapërcen sfidat e brendshme dhe vendi bën progres të kënaqshëm në administrim publik, reformën e drejtësisë dhe reformën zgjedhore, luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar dhe nxitjen e përfshirjes sociale të grupeve të cënueshme. Shqipëria do të përballet me sfida të vazhdueshme lidhur me qeverisjen, mjedisin, mbrojtjen sociale dhe konkurrueshmërinë në nivel ndërkombëtar. Skenari pesimist parashikon amulli në anëtarësim, duke çuar në uljen e pranimit nga publiku të projektit evropian dhe nxitjen e aktorëve të tjerë gjeopolitikë për të zgjeruar praninë e tyre në Shqipëri e rajon.

## Besimi te qeveria dhe angazhimi qytetar

Shoqëria shqiptare nuk ka shumë besim tek institucionet shtetërore. “Ne jemi një shoqëri me besim të ulët[1]”. Kapja e shtetit nga partitë[2] politike dhe liderët e tyre, si dhe presioni nga krimi i organizuar e korrupsioni pengojnë krijimin e institucioneve demokratike efektive dhe zhvillimin në përgjithësi. Pavarësisht kësaj, qytetarët kanë përfituar drejtpërdrejt nga ndryshimet pozitive institucionale, përfshi edhe decentralizimin e reformën në drejtësi. Edhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike, përgjigjshmëria më e madhe ndaj nevojave të qytetarëve dhe rritja e bashkëpunimit midis partive politike janë shenja inkurajuese progresi.

Reformimi i mëtejshëm i administratës publike kërkon burime financiare në nivel vendor, rritjen e angazhimit qytetar dhe garantimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, përfshi këtu edhe zgjedhjet vendore. Në disa fusha janë regjistruar ndryshime pozitive si në menaxhimin financiar publik (MFP), ku përfshihet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe në përmirësimin e kapaciteti statistikor, ku përfshihet Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), por këto përmirësime janë pak të dukshme për publikun. Sidoqoftë, ndërsa institucionet shtetërore bëhen më efektive dhe transparente, ato , do të fitojnë besimin e qytetarëve dhe do të nxisin sektorin privat për t’u angazhuar.

Shqipëria po përmirëson **Kodin Zgjedhor** dhe po shqyrton se cili sistem zgjedhor i përfaqëson më mirë qytetarët e saj, si element jetik i demokracisë. Megjithatë, problemet që kërkojnë vëmendje janë keqpërdorimi i burimeve shtetërore në zgjedhje dhe ndikimi i paligjshëm te votuesit. Në vitet e ardhshme, Shqipëria duhet të trajtojë çështjet e lidhura me listat e hapura, financimin e partive e kandidatëve dhe demokracinë e brendshme të partive politike. Ndonëse numri i grave që hyjnë në sferën politike po rritet, përfaqësimi dhe kapaciteti i tyre për të ndikuar mbi politikën dhe jetën publike mbeten të pamjaftueshme sepse mbizotërojnë ende stereotipat gjinorë rreth rolit të grave si përfaqësuese.

Ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori paraqesin dobësi institucionale dhe një prej sfidave më të mëdha qeverisëse të vendit është vendosja e kontrolleve dhe balancave midis këtyre tri pushteteve.

1 Mendim i dhënë gjatë procesit të konsultimit.

2 Gjatë gjithë periudhës post-komuniste, nuk i duhet atribuar vetëm një force të caktuar politike.

**Angazhimi qytetar** ka pësuar rritje të lehtë gjatë viteve të fundit, por mbetet ende i copëzuar. Kur organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe qytetarët bashkojnë forcat, ata kanë sukses. Megjithatë, aktorët publikë dhe civilë nuk punojnë ende rregullisht për arritjen e qëllimeve ose interesave të përbashkëta kombëtare të cilat të udhëhiqen nga debati, bashkëpunimi dhe mekanizmat e llogaridhënies. Për më tepër, institucionet publike kanë prirjen t'i kontrollojnë OShC-të dhe ta kufizojnë hapësirën e tyre të veprimit. Kjo gjë dobëson besimin e qytetarëve, sidomos të të rinjve, në arritjen e ndryshimeve pozitive bazuar mbi nevoja dhe prioritete të përbashkëta, propozime të shëndosha, procedura konsultuese dhe vendimmarrje transparente.

Zhvillimi i kanaleve të pavarura mediatike pengohet nga interesat e bizneseve të fuqishme dhe ato politike, si dhe nga pronësia e mediave. Gazetarët përballen me siguri të ulët në punë, kanosje dhe autocensurë. Përpjekjet e qeverisë për rregullimin e mediave online për parandalimin e shpifjes janë kritikuar rëndë nga OSBE-ja dhe BE-ja, të cilat kanë paralajmëruar se kjo do të cungonte lirinë e shprehjes të garantuar me kushtetutë.




*Qytetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile protestojnë dhe marshojnë kundër dhunës me bazë gjinore dhe kërkojnë drejtësi dhe veprim për Sabrina Bengaj e cila u vra nga ish-bashkëshorti i saj. Tiranë, 15.09.2021.*

## Rritja dhe varfëria

Shqipëria është vend me të ardhura mesatare të larta në rrugën drejt anëtarësimit në BE. E megjithatë, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) për frymë në vitin 2019 ishte 5,353 dollarë amerikanë (vlera aktuale), një prej vlerave më të ulëta në rajon dhe sa gjysma e shteteve të reja anëtare të BE-së. Tërmeti i 2019-s dhe pandemia e COVID-19 e goditën rëndë ekonominë, pikërisht në vitin kur modeli i rritjes ekonomike kishte filluar të shfaqte shenja brishtësie. Sipas të dhënave paraprake, PBB-ja në Shqipëri ra me 3.3% në vitin 2020, por u rrit sërish në gjysmën e parë të vitit 2021, me perspektivën e një rritjeje reale prej 7.2% për të gjithë vitin. Bujqësia dhe peshkimi janë dy prej kontribuesve më të mëdhenj të PBB-së, ndjekur nga turizmi, tregtia, ndërtimi, hoteleria dhe shërbimet ushqimore.

Pas rritjes me një normë mesatare vjetore prej 6% gjatë periudhës 1998-2008, PBB-ja vjetore e Shqipërisë gjatë periudhës 2008-2014 ra në mesataren vjetore prej 2.4%, për shkak të krizës financiare botërore dhe krizës së Eurozonës. Gjatë periudhës 2015-2018, rritja ekonomike u ngjit në 3.4%, por në vitin 2019 pësoi sërish rënie në 2.2%. Për shkak të qëndrueshmërisë makroekonomike dhe rikuperimit ekonomik të BE-së, kohët e fundit janë shtuar investimet private, eksportet neto (kryesisht turizmi) dhe konsumi. Megjithatë, shtimi i investimeve dhe zhvillimi ekonomik kanë ardhur kryesisht nga projektet e mëdha, të njëhershme, me financime të huaja në sektorin energjetik, përfshirë Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP) që erdhi drejt mbylljes në vitin 2019, si dhe nga sektorët me produktivitet dhe paga relativisht të ulëta si sektori prodhues bazë dhe turizmi i vogël. Sfida aktuale e Shqipërisë lidhur me produktivitetin pasqyrohet edhe nga kapacitetet e ulëta për biznes. Ekonomia dominohet nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), që përbëjnë 99.8% të subjekteve, 82% të punësimit dhe 72% të vlerës së shtuar në sektorin e biznesit. Informaliteti mbetet sërish i përhapur. Në përgjithësi, forcimi i mjedisit ligjor dhe efektiviteti i ndërveprimeve qeveri-biznes janë ndër pengesat më të ngutshme për biznesin në Shqipëri.

Shqipëria është tejet e cënueshme nga faktorë të jashtëm dhe e ekspozuar sidomos ndaj paqëndrueshmërive të importeve energjetike. Turizmi është sektor eksportues kyç i shërbimeve, që përbën 26% të PBB-së. Me rreth 40% të popullsisë që jeton jashtë vendit (kryesisht në Greqi dhe në Itali), Shqipëria renditet ndër përfituesit më të mëdhenj të remitancave, ku transfertat në 2019-n përllogariteshin tek rreth 5.2% e PBB-së. Investimet e huaja direkte (IHD) përqendrohen te transmisioni i gazit dhe sektori energjetik.

Politika monetare ekspansioniste i vjen në ndihmë mbështetjes së ekonomisë, por krediti mbetet i kufizuar. Pavarësisht përpjekjeve për të reduktuar çekuilibrat fiskalë, kriza e COVID-19 në fund të 2019-s e gjeti Shqipërinë me kapacitet dhe hapësirë të kufizuar fiskale, më konkretisht me borxh të lartë publik (68% e PBB-së), me një bazë të dobët të të ardhurave publike, dhe shpenzime të konsiderueshme për mbylljen e boshllëqeve në sektorët socialë dhe infrastrukturë.

Pozita fiskale e vendit u përkeqësua më tej gjatë 2020-s për shkak të pakësimit të të ardhurave dhe rritjes së shpenzimeve për krizën. Borxhi publik në fund të 2020-s llogaritej i barabartë me 82% të PBB-së. Pas kapërcimit të krizës, duhet të rifillojë konsolidimi fiskal, mbledhja efektive e të ardhurave dhe reformat strukturore, për të shmangur ndikimet negative te rritja ekonomike.

Krijimi i vendeve të reja të punës u rrit nga 3% si mesatare vjetore gjatë periudhës 2010-2014 në 4% gjatë periudhës 2015-2019. Në 2019-n, Shqipëria pati normën më të lartë të punësimit në Ballkanin Perëndimor me 53.4% (60.1% M; 46.9% F) të popullsisë në moshë për punë. Megjithatë, norma e papunësisë mbetet sërish e lartë në shifrën 11.7% (me dallime të vogla midis grave dhe burrave) dhe nga hapja e vendeve të reja të punës përfituan kryesisht sektorët më pak të sofistikuar, si prodhimi i tekstileve bazë, shërbimet administrative mbështetëse dhe ndërtimi. Të rinjtë e shohin mungesën e vendeve të përshtatshme të punës si pengesën më të madhe në gjetjen e punësimit. Norma zyrtare e papunësisë së të rinjve (15-29 vjeç) deri në fund të vitit 2020 ishte 21% (20.8% M; 21.1% F). Si kundërpërgjigje, shumë të rinj dhe persona të kualifikuar shqiptarë vazhdojnë të emigrojnë. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore (60%) ka nivele të ulëta arsimore dhe shumë NMVM shprehen se mungesa e punonjësve të kualifikuar është pengesë kryesore, zhvillimi i aftësive profesionale mbetet i rëndësishëm.

Në 2019, 23% e shqiptarëve rrezikoheshin nga varfëria. Një e treta e punësimit është informal dhe shumë familje mezi i plotësojnë nevojat bazë. Sistemi i mbrojtjes sociale të vendit nuk ofron siguri të mjaftueshme nga varfëria. COVID-19 zhyti sërish në varfëri shumë persona të cënueshëm (deri në 118,000, sidomos ata me fëmijë të vegjël dhe të moshuarit).

## Akses i pabarabartë te shërbimet publike

Aksesi te shumë shërbime publike mbetet ende sfidë për personat e cënueshëm, përfshi të varfrit (sidomos gratë me fëmijë), personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komunitetin rom dhe popullsinë rurale. Problemet kryesore janë nivelet e ulëta të mbulimit gjeografik, mekanizmat e dobët të gjithëpërfshirjes dhe efikasiteti i kufizuar alokues dhe teknik. Sipas statistikave më të fundit për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, varfëria (23.4%, baras me 670,000 njerëz) dhe pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave (35.4%) për 2018-n ishin ende të larta. Më shumë se gjysma e popullsisë së varfër ishte pasive, e papunësuar dhe e paarsimuar; ata që jetojnë në zona të largëta shpesh janë të përjashtuar plotësisht. Shkaqet më të përhapura të cënueshmërisë dhe përjashtimit janë papunësia dhe pagat e ulëta; shpenzimet e ulëta publike për shëndetësinë, arsimin, dhe mbrojtjen sociale; dobësi në qeverisje dhe shtetin ligjor; cilësia e luhatshme institucionale dhe boshllëqet në zbatim; pakësimi i burimeve natyrore dhe fatkeqësitë.

Goditja e dyfishtë e tërmetit të 2019-s dhe pandemia në vijim e COVID-19, e kanë përkeqësuar varfërinë dhe përjashtimin. Masat shtrënguese kundër COVID-it kanë sjellë uljen e cilësisë së shërbimeve bazë dhe përkeqësim të aksesit të njerëzve në to. Për më shumë se 8 muaj, aksesi në kujdes shëndetësor ishte i kufizuar dhe programet e parandalimit nuk ishin më funksionale. Dy fatkeqësitë e njëpasnjëshme nxorën në pah nevojën për mbrojtje sociale, shëndetësi, arsim, si dhe për parandalim krize dhe aftësi reaguese.

Sistemi shqiptar i mbrojtjes sociale po merr gradualisht formë, bazuar në tre modalitete komplementare: asistencë financiare, shërbime sociale dhe shërbime aktive në tregun e punës. Strategjitë e miratuara së fundi nga qeveria synojnë decentralizimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, dhe rritjen e përgjigjshmërisë së tyre ndaj nevojave të njerëzve. Për herë të parë, Shqipëria ka operacionalizuar fondin kombëtar social për shërbimet e decentralizuara sociale, në përputhje me planet sociale bashkiake.

Megjithatë, shëndetësia dhe sektorët e tjerë socialë mbeten ende të nënfinancuar dhe larg standardeve të BE-së, ku mbrojtja sociale zë 9.4% të PBB-së, shëndetësia 3%, arsimi 3.2% dhe strehimi e akomodimi 2.2%. Pagesat nga xhepi për kujdesin shëndetësor përbëjnë thuajse gjysmën e shpenzimeve të përgjithshme për shëndetësinë. Sektorët socialë duhen transformuar për të trajtuar nevojat dhe sfidat e vendit, por edhe kërkesat për anëtarësim në BE, si dhe për të përfituar nga mundësitë dhe novacionet që ofron digjitalizimi.

## *Mjedisi, ndryshimet klimatike dhe rreziku nga fatkeqësitë*

*Shqipëria renditet ndër vendet më të rrezikuara nga fatkeqësitë në Europë për shkak të ekspozimit të lartë ndaj dukurive ekstreme natyrore. Shqipëria ka shënuar progres të moderuar në mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar qëndrueshmëri energjetike dhe trajtuar ndikimet e ndryshimeve klimatike. Ndonëse QSh-ja ka treguar mjaft interes në infrastrukturën aeroportuale dhe rrugore, nuk ka zbatuar ende një strategjitë re të menaxhimit të mbetjeve dhe nuk ka ngritur një sistemi rajonal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me standardet e BE-së. Finalizimi dhe zbatimi i Projektplanit të integruar Kombëtar për Energjinë dhe Klimën në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe politikat e BE-së për klimën janë hapa të parë të rëndësishëm drejt së ardhmes pa karbon, që synon përgjysmimin e emetimeve të gazeve serrë në 2tCO2eq për frymë në vitin 2050.*

*Përkushtimi i QSh-së për arritjen e sigurisë dhe efiçencës energjetike duke reduktuar emetimet e gazeve serrë kërkon investime me kosto efektive në energji diellore dhe të erës, si dhe investime të shëndosha nga pikëpamja ekonomike dhe mjedisore në hidroenergjetikë. Projektet hidroenergjetike në lumin Vjosë duhet të jenë në përputhje me normat ndërkombëtare dhe të BE-së lidhur me vlerësimin e ndikimit dhe mbrojtjen mjedisore. Duke qenë se Vjosa është lumi i fundit i egër i Europës, mbrojta e biodiversitetit të saj është çështje me rëndësi ndërkombëtare. Shoqëria civile po bën thirrje aktive për transparencë dhe konsultim.*



*Përmbytjet kanë dëmtuar ultësirat në Shqipëri disa herë në vitet e fundit.*

## Dinamikat rajonale

Si anëtare e NATO-s, Shqipëria është e angazhuar në partneritetin dhe integrimin Euro-Atlantik. Vendi gjithashtu shërbeu në kryesinë e OSBE-së dhe është zgjedhur si anëtar i përkohshëm i Këshillit të Sigurisë së OKB-së, një vit përpara se të merret vendimi për kandidaturën e Zvicrës si anëtare e përkohshme.

Shqipëria angazhohet në nisma rajonale dhe ka marrëdhënie të qëndrueshme me vendet fqinje, pavarësisht disa problematikave, si kufijtë detarë me Greqinë. Dinamikat gjeopolitike në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor përfshijnë edhe praninë kineze, ruse, turke dhe arabe, që në njëfarë mënyre sfidon ndikimin Euro-Atlantik.



*Samiti i Gjashtë Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Tiranë, qershor 2021.*

# 2. Objektivat e politikës së jashtme zvicerane për Shqipërinë dhe kontributi i partnerëve të tjerë të zhvillimit

Zvicra dhe Shqipëria kanë vendosur marrëdhënie diplomatike që prej vitit 1970. Asokohe, Zvicra ishte në prag të përfundimit të sistemit të kahershëm demokratik, duke miratuar më në fund të drejtën e votës së grave. Shqiptarët do të jetonin nën regjimin komunist edhe për 20 vjet të tjera. Zvicra filloi t'i ofrojë vendit mbështetje të konsiderueshme në vitet 1990, pas rënies së regjimit komunist.

Interesat e politikës së jashtme zvicerane me Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor e vënë theksin te paqja, qëndrueshmëria, ngritja e shtetit demokratik, shteti ligjor, begatia, si dhe mbështetja e integrimit të Shqipërisë në BE. Në këtë vazhdë, Shqipëria ka ndërmarrë një axhendë mjaft të rëndësishme reformuese, me orientim nga Acquis Communautaire e BE-së dhe Axhenda 2030 e OKB -së. Reformat do t'i mundësojnë vendit ndryshime pozitive për qytetarët e sektorin privat dhe do ta ndihmojnë të ecë përpara në rrugën e anëtarësimit në BE.

Në përgjigje të tërmetit të 2019-s, aktorët ndërkombëtarë shfaqën solidaritet të jashtëzakonshëm, i cili kulmoi me konferencën e donatorëve të BE-së për- Shqipërinë në Bruksel, në shkurt të 2020-s, ku Zvicra dha një kontribut prej 10.24 milionë frangash zvicerane. Menjëherë pas kësaj pandemia e COVID-19 e vështirësoi përgjigjen ndaj tërmetit si dhe punën reformuese , duke kërkuar reagime të tjera shtesë për mbajtjen nën kontroll të përhapjes së sëmundjes.

Marrëdhëniet ekonomike midis Zvicrës dhe Shqipërisë kanë në qendër tregtinë farmaceutike, energjinë, ushqimet, shërbimet ndërtimore dhe turizmin i cili vjen në rritje. TAP-i është një prej investimeve më të mëdha të huaja dhe zvicerane nëpërmjet të cilit vjen gaz ngaAzerbajxhani për në rrjetin evropian të gazit përmes Shqipërisë,. Disa vite më parë, u themelua Dhoma e Tregtisë Zvicër-Shqipëri (SWISSA); ekzistojnë mundësi të konsiderueshme për zgjerimin e lidhjeve ekonomike midis dy vendeve.

Vitet e fundit, Zvicra ka dhënë një kontribut prej 100 milionë frangash zvicerane në vit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet e Ballkanit Perëndimor. Prej këtij kontributi, 25 milionë franga në vit shkojnë për Shqipërinë, duke e bërë Zvicrën donatorin e dytë më të madh në vend.

Këto shifra pasqyrojnë rëndësinë e 'fqinjësisë' rajonale lidhur me qëllimet e lartpërmendura të politikës së jashtme zvicerane.[3]

Ndonëse Shqipëria nuk është vend që varet nga ndihmat, flukset e ndihmave janë burim i rëndësishëm i financimit të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Angazhimet vjetore të Ndihmës Zyrtare për Zhvillim (ODA) përbënin 1.8% të PBB-së gjatë periudhës 2013-2019. Nëse përfshihen të gjitha llojet e financimit, disbursimet e ndihmës si përqindje e buxhetit të qeverisë për po të njëjtën periudhë janë të konsiderueshme - baras me një mesatare vjetore prej 24.2%. Partnerët kryesorë shumëpalësh të zhvillimit të Shqipërisë janë BE-ja, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Banka Botërore dhe OKB-ja. Gjermania, Zvicra, ShBA, Suedia, Austria dhe Turqia kanë qenë donatorët dypalësh më të rëndësishëm për periudhën 2015-20019.

SDC dhe SECO ndajnë përgjegjësinë për asistencën që Zvicra i ofron Shqipërisë që prej 1992-shit dhe veprojnë në mënyrë komplementare sipas fushave të tyre të ekspertizës. Asistenca zvicerane ka qenë e dobishme dhe ka dhënë kontribut pozitiv për politikat dhe sistemin shqiptar, falë veprimtarisë intensive të ODA-s zvicerane, natyrës së integruar të përfaqësisë zvicerane dhe mënyrës së të punuarit, që karakterizohet nga neutraliteti dhe qasja afatgjatë, duke u përqendruar te cilësia gjatë zbatimit, puna në partneritet dhe forcimi i bashkëpunimit me BE-në.

QSh-ja dhe partnerët e saj kryesorë të zhvillimit kanë krijuar mekanizma koordinimi për bashkëpunimin ndërkombëtar. Zvicra bashkëdrejton mekanizmin e koordinimit për decentralizimin, arsimin dhe formimin profesional, dhe shëndetësinë, si dhe kontribuon edhe në fusha të tjera të rëndësishme. Për periudhën e ardhshme të bashkëpunimit, Zvicra do të vijojë të përmirësojë koordinimin donatorë-qeveri në kuadër të: (1) lidhjeve më të mira midis rezultateve e burimeve dhe përmirësimit të qasjeve sektoriale, (2) vijimësisë më të madhe të strukturave dhe përgjegjësive qeveritare, (3) harmonizimit më të mirë të mbështetjes së donatorëve, përfshi edhe përdorimin e sistemit të vendit dhe (4) përmirësimit të llogaridhënies (së brendshme dhe të përbashkët).

3 'Fqinjësia' i referohet edhe komuniteteve të rëndësishme të diasporës nga rajoni i Ballkanit Perëndimor që jetojnë në Zvicër, ndonëse diaspora shqiptare është më e vogël krahasuar me atë të vendeve të tjera.




*Ministri i Jashtëm i Zvicrës Ignazio Cassis i drejtohet medias gjatë vizitës së tij në Shqipëri në nëntor 2020.*

# 3. Rezultatet e Zvicrës për periudhën 2018-2021 dhe mësimet e nxjerra

## 3.1. Qeverisja demokratike

Zvicra e ka mbështetur decentralizimin dhe qeverisjen vendore në Shqipëri për mbi 20 vjet. Gjatë periudhës 2018-2021, bashkëpunimi zviceran është përfshirë edhe në forcimin e Kuvendit të Shqipërisë. Për sa i përket pjesëmarrjes qytetare, falë mbështetjes zvicerane, mbi 100 nisma civile kanë ndikuar te vendimet dhe shërbimet e qeverisjes vendore. Një prej arritjeve më të rëndësishme për qytetarët në nivel vendor është edhe përmirësimi i aksesit në shërbime të veçanta.. Për shembull, menaxhimi i mbetjeve në bashkitë e mbështetura është përmirësuar deri në 70%; 60 bashki kanë tashmë plane sociale dhe thuajse gjysma përfitojnë fonde nga fondi social kombëtar. Bashkitë kanë forcuar kapacitetet menaxhuese, sidomos në buxhetimin shumëvjeçar, administrimin e të ardhurave të veta dhe përcaktimin e treguesve të performancës. Thuajse të gjitha bashkitë kanë rikonfiguruar ofrimin e 70 shërbimeve administrative nëpërmjet zyrave me një ndalesë dhe kanë ngritur komisionet gjinore bashkiake. Këto komisione kanë krijuar lidhje edhe me Gratë Këshilltare, një rrjet me gra këshilltare dhe ish-këshilltare , duke siguruar edhe pjesëmarrje nga opozita politike pavarësisht se kjo e fundit nuk ishte e përfaqësuar në këshilla bashkiakë.



*Bashkitë patën detyra sfiduese pas tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019. Në foto: Kryetarja e Bashkisë Kurbin Majlinda Cara me stafin e saj.*

Si bashkitë ashtu edhe kuvendi kanë treguar nivel të lartë novacioni gjatë krizës së COVID-19, për shembull duke transmetuar debatet, gjë që ka hedhur themelet për transparencë më të madhe të legjislativit në nivele vendore dhe kombëtare. Bashkitë i kanë përshtatur prioritetet e tyre sipas nevojave të ngutshme të popullsisë, për të mbështetur më të cënueshmit, dhe në disa raste, bizneset vendore përmes pezullimit të përkohshëm të detyrimeve fiskale.

Përmirësimi i disponueshmërisë së statistikave në nivel rajonal dhe mbledhja e të dhënave mbi përfshirjen sociale do të sjellin politika më të informuara dhe gjithëpërfshirëse në nivele vendore dhe kombëtare. Për sa i përket reformave kombëtare, miratimi i ligjit për zhvillimin dhe kohezionin rajonal shërben si bazë e shëndoshë për zhvillim rajonal. Miratimi i planit strategjik të Kuvendit ka hapur rrugën e funksionimit më të mirë të legjislativit. Përcaktimi i standardeve për arsimin parashkollor - shërbim ky që i është deleguar bashkive në kuadër të decentralizimit - shërben si standard krahasimor për ofrimin e shërbimeve në nivel vendor.

Mësimet e nxjerra gjatë periudhës 2018-2021 kanë të bëjnë kryesisht me rëndësinë e kontrolleve dhe balancave për forcimin e demokracisë. Në kontekstin aktual, nevoja për forcimin e rolit mbikëqyrës të organeve ligjvënëse në nivel kombëtar dhe vendor, dhe mbështetja e aktorëve jashtë këtyre organeve zyrtare (Kuvendi dhe këshillat bashkiakë), merr rëndësi edhe më të madhe. Mbështetja e shoqërisë civile e cila është tejet e përçarë kërkon qasje novatore si dhe punë me lloje të ndryshme të palëve të interesit siç janë lëvizjet qytetare, grupe interesi dhe individë. Mbrojtja sociale është temë mjaft e rëndësishme për Shqipërinë në kuadër të anëtarësimit të saj në BE. Mbështetja e Zvicrës dhe e OKB-së mbulon edhe shërbime sociale për personat e cënueshëm - përfshi këtu edhe sistemin kombëtar (fondin social) -dhe masa për tregun e punës. Mekanizmi i fondit social kombëtar, së bashku me planet sociale vendore, mbështet ofrimin e shërbimeve sociale të decentralizuara dhe integruara.

# 3.2. Zhvillimi ekonomik dhe punësimi

Gjatë periudhës 2018-2021, portofoli zviceran për zhvillimin ekonomik dhe punësimin pati në qendër qëndrueshmërinë makroekonomike, zhvillimin e sektorit privat dhe punësimin e të rinjve, përfshi edhe zhvillimin e aftësive profesionale.

Rezultatet më të spikatura janë:

- Mbështetja e Këshillit Shqiptar të Investimeve për të shërbyer si platformë kyçe ku qeveria dhe sektori privat të diskutojnë politikat dhe reformat për mjedisin e biznesit, veçanërisht në mbështetje të masave për zbutjen e efekteve të COVID-19.
- Proceset buxhetore të orientuara drejt performancës, borxhi publik dhe rreziqet fiskale tashmë menaxhohen më mirë.
- Banka qendrore ka forcuar kapacitetin e saj për hartimin e politikës monetare dhe për t'iu përgjigjur tronditjeve të jashtme.
- Sektori financiar jo-bankar është më i zhvilluar dhe më i qëndrueshëm, falë përmirësimit të kuadrit rregullator.
- Shqipëria ka përmirësuar tashmë regjimin mbi falimentimet dhe sistemin e raportimit financiar të kompanive në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standardet e BE-së.
- Mjedisi i biznesit ka nxitur 20 milionë euro shtesë në investime nga sektori privat dhe ka kursyer 1.5 milionë euro në kosto të përputhshmërisë.
- Shoqëritë e përzgjedhura (në veçanti NVM dhe bizneset e reja) kanë forcuar konkurrueshmërinë e tyre në rang ndërkombëtar përmes një ekosistemi më të fortë sipërmarrës.
- Janë hapur 3,600 (48%f) vende pune të reja, janë punësuar 820 të rinj (45%f), 17,627 personave (38%f) iu është ofruar formim profesional dhe 2,316 (21%f) praktikantë janë mirëpritur nga 590 shoqëri (duke pasqyruar angazhimin e fuqishëm të sektorit privat).




*Rritja e eksporteve të Shqipërisë duhet të përputhet me vendosjen e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të cilësisë me synim sigurimin e konkurrueshmërisë dhe integrimit.*

Disa prej mësimeve më të rëndësishme të nxjerra janë: (i) pavarësisht progresit të konsiderueshëm, nevojiten përpjekje të tjera për forcimin e konsolidimit dhe elasticitetit makroekonomik, sidomos në MFP, për mobilizimin e burimeve dhe përdorimin efikas të fondeve publike; (ii) mjedisi i biznesit ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm për të forcuar konkurrueshmërinë (sidomos për NVM-të dhe bizneset e reja) dhe lidhjet ekonomike rajonale, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e sektorit privat në reformimin e politikëbërjes ekonomike, duke pasur parasysh rëndësinë e ekonomisë informale; dhe (iii) nevojitet fokusimi më i mirë te krijimi i vendeve të denja të punës dhe përpjekje shtesë për të forcuar rregullimet institucionale për zhvillimin e aftësive të orientuara drejt tregut dhe shërbimet e ndërmjetësimit të punësimit.

# 3.3. Infrastruktura urbane dhe energjia

Gjatë periudhës 2018-2021, bashkëpunimi zviceran në këtë fushë pësoi transformim të konsiderueshëm - duke kaluar nga trajtimi i sfidave të ndërmarrjeve ose bashkive individuale në mbështetjen e sektorëve të tërë - gjë që solli efekt sistemik. Për pasojë, financimi i investimeve në infrastrukturë "fizike" ra dhe u rritën kontributet për mbështetjen e infrastrukturës "jofizike", si asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh.

Rezultatet më të spikatura janë:

- Sektori i gazit ka përmirësuar kuadrin politik dhe rregullator, si dhe ka forcuar kapacitetet institucionale.
- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESh) ka ngritur dhe ka vënë në funksion instrumentet për sigurinë e digave dhe sistemet e monitorimit mbi lumenjtë Drin dhe Mat, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave të BE-së.
- Rajonii Beratit ishte ndër të parët që operoi vend-depozitimet e rehabilituara dhe të përmirësuara të mbeturinave, në përputhje me të gjitha rregulloret kombëtar, dhe 185,000 njerëz përfitojnë tashmë nga shërbimi bazë i mbetjeve të ngurta .
- Gjashtë ndërmarrje publike në qytete dytësore përmirësuan performancën e tyre operacionale dhe financiare, duke rezultuar në shërbime më të mira ujësjellës-kanalizime për 400,000 njerëz.



*Modernizimi i ndërmarrjeve ujësjellëse ecën krahas ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe forcimit të menaxhimit të tyre.*

Disa prej mësimeve të nxjerra janë: (i) institucionet kryesore kanë aftësi dhe kapacitete të kufizuara për zbatimin e kuadrove politike dhe ligjore në fusha si përballimi i fatkeqësive natyrore (PFN); (ii) shërbimet përmirësohen në mënyrë të qëndrueshme vetëm kur kapacitetet individuale dhe institucionale konsolidohen në ndërmarrjet publike e bashki dhe kur rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve; (iii) ndërhyrjet e përbashkëta me partnerët e tjerë të zhvillimit në të gjitha nivelet sjellin rezultate më të prekshme e më të qëndrueshme dhe mundësojnë zbutje më efektive të faktorëve të jashtëm të riskut; (iv) qasja e bazuar në performancë ka dhënë rezultate të mira dhe mbështetet nga QSh-ja e partnerët më të mëdhenj të zhvillimit; dhe (v) përfshirja sociale e grupeve me të ardhura të ulëta/të cënueshme kërkon masa të shënjestruara në disa nivele.

# 3.4. Shëndetësia

Si donatori më i madh dypalësh në sektorin e shëndetësisë, Zvicra ka ndihmuar në përmirësimin e kujdesit shëndetësor parësor (KShP) dhe për pasojë 10% më shumë qytetarë po përdorin shërbimin (sidomos gra). Ka filluar mbështetja përshërbimin e kujdesit në shtëpi dhe priten përmirësime në identifikimin e hershëm dhe monitorimin e sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT). Kjo do të lejojë shërbime shëndetësore më gjithëpërfshirëse të cilat do të jenë në gjendje të shkojnë deri te personat e cënueshëm, përfshi edhe të moshuarit. Mbi 150,000 (57%F) njerëz janë arritur nga sesione edukuese shëndetësore dhe fushatave televizive që trajtojnë faktorët e riskut të SJT-ve dhe rëndësinë e KShP-së. Do të duhet kohë për ndërgjegjësimin rreth faktorëve të riskut të SJT-ve dhe për një efekt në frekuencën e sëmundjes. Gjatë krizave të njëpasnjëshme të tërmetit të 2019-s dhe pandemisë së COVID-19, Zvicra reagoi shpejt duke e mbështetur qeverinë e Shqipërisë me rindërtimin e tre qendrave shëndetësore, pajisje mjekësore, ngritjen e kapaciteteve online të ofruesve shëndetësore për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit dhe me fushatë ndërgjegjësuese për komunitetin e gjerë.

Strategjia e parë kombëtare e Shqipërisë për KShP-në, hartuar me mbështetjen e Zvicrës, u miratua në 22020-n, duke u hapur udhë shërbimeve të përmirësuara. Megjithatë, krizat e njëpasnjëshme ndikuan fort te prioritetet e QSh-së, duke prekur drejtpërdrejt rrugëtimin dhe ritmin e reformave.

Sfidat dhe mësimet kryesore në këtë sektor kanë të bëjnë me shkallën e lartë të centralizimit në sistemin shëndetësor, mungesën e financave dhe informacionit, kontrolle dhe balanca të kufizuara dhe pjesëmarrjen e dobët të shoqërisë civile. Shqetësim tjetër është emigrimi i punonjësve shëndetësorë dhe mungesa e një strategjie kombëtare për menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin shëndetësor. Kriza e COVID-19 nxori në pah pikat e forta e të dobëta të sistemit shëndetësor si dhe rriti kërkesën e popullsisë dhe OShC-ve. Agjentët e ndryshimit në sektorin publik kërkojnë më tepër mbështetje dhe zëri i shoqërisë civile e qytetarëve duhet të forcohet për të nxitur reforma kombëtare. Veprimet e vogla mund të kenë ndikime të rëndësishme në politika. Ky sektor mund të përfitonte nga një koordinim më i fortë i donatorëve dhe nga mbështetja e BE-së për shëndetësinë në të ardhmen.

# 4. Implikimet për Programin e Bashkëpunimit 2022-2025

Zvicra do të **vijojë** punën në katër fusha: qeverisje demokratike, zhvillim ekonomik dhe punësim, shërbime infrastrukturore e ndryshime klimatike, dhe shëndetësi (shihni kuadrin e rezultateve në Shtojcën 2). Puna do të përfshijë kontributin për (i) bashki të forta si dhe institucione publike gjithëpërfshirëse, efektive dhe të pavarura në nivel kombëtar për qeverisje të mirë, demokraci, barazi gjinore, dhe shërbime publike (përfshi mbrojtjen sociale), forcim të kontrolleve dhe balancave dhe angazhim qytetar; (ii) një model shqiptar i arsimit e formimit profesional (AFP) dhe punësim më i mirë; (iii) një kuadër i shëndoshë makroekonomik dhe përgatitjet kundër tronditjeve të mundshme; (iv) një mjedis më i mirë për biznesin dhe rritje ekonomike e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse; (v) infrastrukturë urbane dhe energji për shërbime më të mira dhe menaxhimin e ndryshimeve klimatike; dhe (vi) mbulim më të mirë të kujdesit shëndetësor parësor dhe njohuri më të mira shëndetësore për shëndet më të mirë. 'Askush të mos mbetet pas' vijon të jetë parimi orientues.

**Ndryshimet dhe përshtatjet** mund të përfshijnë forcimin e mbështetjes për angazhimin qytetar, si dhe mbështetje të përshtatur për Parlamentin (në fushën e qeverisjes demokratike), krijimin e mundësive për forcimin e mbrojtjes sociale (në fushat e qeverisjes demokratike dhe zhvillimit ekonomik), fokus më të mprehtë te forcimi i sektorit dhe trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore (në fushën e shërbimeve infrastrukturore dhe ndryshimeve klimatike) dhe mbështetje për gatishmëri dhe reagim në rast emergjencash për të rritur besimin te një sistemi shëndetësor më elastik. (në fushën e shëndetësisë). Nxitës të ndryshimit (të rinj, diaspora, sektori privat, qytetarët e angazhuar, aktorët fetarë, gratë në politikë etj.) do të identifikohen si aktorë që kërkojnë dhe shfaqin përkushtim ndaj reformave si dhe lidership në zbatimin e këtyre reformave dhe në krijimin e institucioneve efektive. Modalitetet e bashkëpunimit do të vlerësohen me synimin për të sjellë ndryshime pozitive për njerëzit dhe institucionet.

Për ta ndihmuar Shqipërinë të reduktojë korrupsionin masiv dhe ndikimin e krimit të organizuar te institucionet shtetërore dhe qytetarët, Zvicra do të forcojë sistemin e kontrolleve dhe balancave nëpërmjet mbështetjes së organeve ligjvënëse, proceseve transparente dhe efektive të konsultimit, institucioneve të pavarura, administratës efektive publike dhe forcimit të angazhimit qytetar. Bashkëpunimi zviceran do të mbështesë edhe përpjekjet për të identifikuar dhe trajtuar shkaqet thelbësore të krimit të organizuar.

Bashkëpunimi ekonomik do të fokusohet te aksesi në tregje dhe mundësive që vijnë falë kushteve më të besueshme të kuadrit, si dhe tek krijimi i mundësive për të ardhura përmes nismave novatore të sektorit privat, p.sh duke vendosur standarde në zinxhirin e vlerave për forcimin e konkurrueshmërisë. Mbështetja për një menaxhim të shëndoshë makroekonomik dhe MFP-ja në nivel nënkombëtar kontribuojnë ndjeshëm në qeverisjen e mirë. Mbështetja për infrastrukturën urbane do të kalojë nga qasja e financimit të pajisjeve te qasja që synon krijimin e sektorëve të orientuar drejt performancës dhe shërbimeve. Programi i bashkëpunimit do të trajtojë **ndryshimet klimatike** dhe rreziqet natyrore pikësëpari nëpërmjet perspektivës së shërbimeve infrastrukturore (sidomos furnizimin me energji të rinovueshme dhe efiçencën energjetike), në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja në fushat e tjera të angazhimit.

Ka shumë rëndësi që **të komunikohet** ndryshimi pozitiv drejt institucioneve më efektive, përfshi këtu edhe fushat që janë më pak të prekshme për publikun e gjerë. Ambasada Zvicerane do të formulojë më tej edhe mesazhet kryesore të politikës lidhur me progresin e Shqipërisë kundrejt progresit të reformave dhe punës së papërfunduar, si dhe interesat e politikës së jashtme zvicerane. Do të merret parasysh edhe reagimi kundër COVID-19 dhe përpjekjet rimëkëmbëse nga tërmeti (përfshi zotimin që Zvicra ka bërë në Bruksel në fillim të 2020-s) si dhe mësimet e nxjerra për të rindërtuar më mirë, më gjelbër dhe më drejtë. Bashkëpunimi zviceran do t'iu kushtojë vëmendje aspekteve të shumta të përjashtimit dhe do të identifikojë si duhet grupet në shënjestër për çdo operacion, duke i dhënë prioritet, kur është e mundur, grave të cënueshme, familjeve rome, të rinjve të papunësuar, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.Do të kontribuojë për mundësi për të rinjtë nëpër të gjithë vendin dhe në sektorë të ndryshëm për trajtimin e migracionit.

Meqë Shqipëria është vend me të ardhura mesatare që pritet të anëtarësohet në BE, programi aktual i bashkëpunimit i orientuar nga ODA zvicerane do të transformohet në të ardhmen në program bashkëpunimi Zvicër-Shqipëri, të ngjashëm me atë të shteteve të tjera të Evropës Lindore, tashmë anëtare të BE-së. Duke pasur parasysh këtë perspektivë, programi 2022-2025 do t'u kushtojë vëmendje prioriteteve evoluese, modaliteteve dhe kanaleve të realizimit të bashkëpunimit, si dhe përdorimit të sistemit të vendit, shkëmbimeve mes kolegëve dhe qasjeve të binjakëzimit. Programi do të reflektojë në mënyrë periodike rreth mënyrës se si të krijojë në të ardhmen programin e bashkëpunimit Zvicër-Shqipëri, jo të orientuar nga ODA, dhe se si të sigurojë burimet e kërkuara.

# 5. Orientimi strategjik dhe prioritetet zvicerane 2022-2025

**Synimi i përgjithshëm i Programit të Bashkëpunimit 2022-2025 është të kontribuojë për një demokraci funksionale, institucione dhe shërbime publike efektive; ekonomi tregu të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse e konkurruese; zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe arritjen e zbatimin e standardeve dhe vlerave evropiane.**

Gjatë periudhës 2022-2025, Zvicra dhe Shqipëria do të angazhohen në një program bashkëpunimi të orientuar drejt reformave dhe rezultateve, me buxhet bashkëpunimi po aq të lartë sa ai i mëparshmi (2018-2021). Reformat do të përmirësojnë demokracinë, shtetin ligjor, klimën e biznesit dhe kushtet e jetesës së shqiptarëve; do të kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe do të mbështesin integrimin evropian të Shqipërisë. Cilësia në zbatim do të jetë parimi kyç i punës sonë të përbashkët.

## 5.1 Qeverisja demokratike

*Njerëzit përfitojnë nga institucione gjithëpërfshirëse, efektive dhe demokratike*

- Rezultati 1.1: Institucionet publike nën-kombëtare ofrojnë shërbime efektive për të gjithë shqiptarët, përfshi edhe ata më të cënueshmit.
- Rezultati 1.2: Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiakë i ushtrojnë më mirë funksionet e tyre mbikëqyrëse, ligjvënëse dhe përfaqësuese.
- Rezultati 1.3: Qytetarët dhe shoqëria e organizuar civile forcojnë angazhimin në përcaktimin e axhendës dhe në vendimmarrje, si dhe u kërkojnë llogari institucioneve publike.

**Teoria e ndryshimit:**

**Nëse qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile organizohen, angazhohen në përcaktimin e axhendës dhe në vendimmarrje, si dhe i kërkojnë llogari institucioneve, dhe nëse institucionet publike ligjvënëse dhe ekzekutive janë të gatshme dhe në gjendje të përgjigjen, atëherë këshillat parlamentarë dhe vendorë do të përmbushin funksionet bazë, dhe qeverisja demokratike dhe ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse do të përmirësohen, sepse një shoqëri civile aktive, kritike dhe konstruktive, dhe institucione që japin llogari janë përbërës themelorë për një demokraci dhe qeverisje pluraliste.**

Gjatë punës drejt arritjes së rezultateve të këtij portofoli, bashkëpunimi zviceran synon të vijojë më tej angazhimin e tij në axhendën e Shqipërisë për decentralizim, duke u fokusuar te zbatimi i thelluar i reformave, për ta bërë ofrimin e shërbimeve më efikas, sidomos lidhur me përfshirjen sociale dhe mjedisin. Qeveritë vendore do ta përmirësojnë performancën dhe menaxhimin e tyre financiar, duke u bërë më transparente, mbështetur në të dhëna të besueshme dhe duke dekurajuar praktikat korruptive. Ato do të jenë më të hapura ndaj bashkëpunimit me qytetarët, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Kapërcimi i përfaqësimit të kufizuar në pushtetin ligjvënës në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe i kapaciteteve të dobëta ligjvënëse dhe mbikëqyrëse, kërkon angazhim të gjithanshëm me organe të tjera shtesë për të siguruar përmirësimin e kontrolleve dhe balancave. Disa institucione të pavarura kontribuojnë në forcimin e funksionit mbikëqyrës të pushtetit ligjvënës. Është thelbësore që shoqëria civile të përfshihet më tepër në monitorimin e zbatimit të ligjit nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore.

Qytetarët, përfshi edhe më të cënueshmit, mund të ndikojnë në përcaktimin e axhendës dhe në vendimmarrje nëpërmjet angazhimit si individë, grupe interesi, lëvizje ose organizata të shoqërisë civile në nivel vendor dhe kombëtar. Shoqëria civile ka një zë të fuqishëm në çështjet sociale, ekonomike dhe mjedisore (përfshi edhe ndryshimet klimatike) dhe propozon zgjidhje përmes dialogut konstruktiv me institucionet publike. Shoqëria civile gjithashtu promovon llogaridhënien, transparencën dhe besimin brenda shoqërisë; përqafon novacionet e brendshme dhe advokon për një digjitalizim të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës të shoqërisë.



*Fëmijë dhe të rinj me aftësi ndryshe nga 23 bashki po marrin shërbime sociale të përmirësuara.*

Për t'i dhënë dorë arritjes së këtyre objektivave, programi i bashkëpunimit do të rrisë mbështetjen financiare për angazhimin e qytetarëve dhe të shoqërisë civile, si dhe do të forcojë mbrojtjen sociale. Kjo e fundit do të arrihet përmes programit "Askush të mos mbetet pas" (LNOB) dhe mbështetjes për punësim, dialog politikash përfshirë financimin e mbrojtjes sociale (buxheti shtetëror, buxheti bashkiak, burimet e jashtme) dhe binjakëzimit me institucione zvicerane. Mbështetja për zhvillimin rajonal do të përfundojë në fillim të vitit 2023

# 5.2 Zhvillimi ekonomik dhe punësimi

**Teoria e ndryshimit:**

**Nëse Shqipëria mbështetet për të konsoliduar një kuadër të besueshëm makroekonomik dhe një mjedis të përmirësuar biznesi dhe miqësor për novacionin, që nxit një sektor privat më të shëndetshëm, konkurrues dhe produktiv, dhe nëse përmirësohet punësimi i të rinjve atëherë qëndrueshmëria financiare dhe konvergjenca e qëndrueshme ekonomike do të mundësojnë që ekonomia të rritet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, sepse institucionet publike shqiptare dhe aktorët e sektorit privat krijojnë vende pune më të denja dhe më të shumta dhe janë të përkushtuar ndaj parimeve të qeverisjes së mirë ekonomike dhe përmirësimit të mjedisit të biznesit**

Zvicra do të vijojë të forcojë aftësinë e partnerëve të saj për të pasur një kuadër makroekonomik të besueshëm dhe një treg financiar e kapitalesh të qëndrueshëm. Ndërhyrjet zvicerane synojnë përmirësimin e mëtejshëm të MFP-së në nivel kombëtar dhe vendor, duke u fokusuar te mobilizimi i burimeve, si dhe te menaxhimi efektiv, transparent dhe me llogaridhënie i shpenzimeve publike . Programi i bashkëpunimit do të forcojë edhe rregullatorët e sektorit financiar dhe autoritetet mbikëqyrëse. Këto masa do të përgatisin terrenin për më shumë elasticitet makroekonomik.

*Qytetarët kontribuojnë dhe përfitojnë nga rritja e qëndrueshme ekonomike, mundësitë më të shumta për biznes dhe vende të denja të punës*

- Rezultati 2.1: Një kuadër i besueshëm makroekonomik që rrit elasticitetin, përmirëson dhënien e shërbimeve dhe rrit besimin e qytetarëve dhe bizneseve për të konsumuar dhe investuar.
- Rezultati 2.2: Një mjedis biznesi miqësor me novacionin kontribuon drejt rritjes së konkurrueshmërisë, produktivitetit, investimeve, dhe mundësive për punësim.
- Rezultati 2.3: Punësueshmëria (e të rinjve) përmirësohet nëpërmjet zhvillimit të aftësive të vlefshme për tregun dhe shërbimeve efektive të tregut të punës.



*Angazhimi me sektorin privat është thelbësor për përmirësimin e punësimit të të rinjve në Shqipëri.*

Zvicra do të vijojë të promovojë reforma dhe një mjedis e biznesi miqësor me novacionin për të rritur konkurrueshmërinë, produktivitetin dhe investimet në mënyrë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore. SECO dhe SDC-ja do të punojnë së bashku si dhe me partnerët e sektorit publik dhe privat për të përshpejtuar reformat dhe nxitur rritjen e sektorit privat, investimet miqësore me klimën dhe krijimin e vendeve të denja të punës. Në qendër të kësaj mbështetjeje do të jenë përpjekjet për të përmirësuar aksesin e sipërmarrësve në burime - përfshi financa, ekspertizë e teknologji -, dhe në diversifikim tregu, si dhe për të lehtësuar përputhshmërinë e bizneseve me rregulloret dhe standardet e cilësisë. Bashkëpunimi zviceran do të fokusohet veçanërisht te forcimi i dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat, gjë që është jetike për krijimin e besimit te qytetarët dhe bizneset. Duke ndërtuar dhe përshkallëzuar përvojat e kaluara mund të lehtësohet ndryshimi sistemik, duke mbajtur parasysh nevojën kritike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik .

Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive do të mbetet në fokus të angazhimit zviceran. Të rinjtë e të rejat duhet të kenë mundësinë të gjejnë vende të denja pune, të ndihmuar edhe nga një sistem më i optimizuar i AFP-së, që karakterizohet nga rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat, nga metoda mësimore novatore dhe me përgjigjshmëri gjinore, si dhe nga teknologjitë. Qasje të reja dhe gjithëpërfshirëse ndaj aktivizimit të tregut të punës (si mjet për forcimin e mbrojtjes sociale), duke shtuar mundësitë për trajnime private novatore dhe shërbime të reja për ndërmjetësimin e punësimit do të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dhe potencialit të njerëzve gjatë gjithë jetës.

## 5.3 Shërbimet infrastrukturore dhe ndryshimet klimatike

*Njerëzit përfitojnë nga përmirësimi i aksesit në shërbime të infrastrukturës ekonomike të qëndrueshme dhe nga trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe efekteve të tyre*

- Rezultati 3.1: Njerëzit përfitojnë nga shërbime të besueshme dhe të përballueshme të ujësjellësit, kanalizimeve dhe mbetjeve të ngurta që ofrohen nga institucione publike efektive.
- Rezultati 3.2: Autoritetet kombëtare dhe vendore e menaxhojnë energjinë në mënyrë të qëndrueshme për të ndihmuar zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe mbështetin qytetet dhe komunitetet për të rritur elasticitetin përballë fatkeqësive natyrore.

**Teoria e ndryshimit:**

**Nëse institucionet publike përmirësojnë kapacitetet për ofrimin e shërbimeve infrastrukturore dhe i menaxhojnë burimet energjetike dhe natyrore në mënyrë më të qëndrueshme, atëherë institucionet publike do të jenë më efektive, elasticiteti i vendit ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore do të rritet, dhe njerëzit e bizneset do të përfitojnë shërbime të përmirësuara sepse Shqipëria është përkushtuar ndaj tranzicionit energjetik, mbrojtjes mjedisore dhe zhvillimit të burimeve energjetike kombëtare të qëndrueshme.**

Zvicra do të vijojë të forcojë aksesin e drejtë në shërbimet cilësore të infrastrukturës ekonomike në sektorin e ujit, mbetjeve të ngurta dhe energjisë. Në të gjithë sektorët mbështetja e Zvicrës do të ofrohet në dy nivele për të sjellë ndryshime sistemike. Në nivel politikash dhe në bashkëpunim me partnerët, Zvicra do të mbështesë qeverinë në zbatimin e kuadrove të përmirësuar politikë dhe rregullatorë. Në nivelin e ofruesve të shërbimeve, do të vazhdohet me mbështetje për të forcuar zhvillimin e tyre korporativ, për të rritur efektivitetin e performancës së tyre operacionale dhe financiare. Duke ndërtuar dhe përshkallëzuar përvojat e mëparshme, Zvicra do të ndërmarrë ndërhyrje të përbashkëta me partnerët kryesorë të zhvillimit, për të zbatuar qasjen e bazuar në performancë në sektorin e ujit, mbetjeve të ngurta dhe energjisë. Për ta mprehur fokusin e portofolit të saj, Zvicra do të reduktojë gradualisht angazhimin në sektorin e mbetjeve të ngurta.

Zvicra do të mbështesë autoritetet kombëtare dhe vendore në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj. Me mbështetjen zvicerane, partnerët do të mund t'i menaxhojnë burimet natyrore në mënyrë më të qëndrueshme, sidomos nëpërmjet përdorimit efiçent të energjisë dhe diversifikimit të burimeve energjetike të rinovueshme, që janë hapa të rëndësishëm në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, Zvicra do të shtojë përpjekjet për të forcuar kapacitetet e burimeve njerëzore, për të përmirësuar kuadrot politikë dhe institucionalë, si dhe do të prezantojë masa novatore për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Ndërhyrje të reja po planifikohen (SECO) dhe vlerësohen (SDC) me autoritetet kombëtare dhe vendore për t'i ndihmuar bashkitë dhe komunitetet të forcojnë elasticitetinpërballë ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore/mjedisore.




*Burime energjie të rinovueshme dhe alternative gradualisht po hyjnë në sistemin energjitik të Shqipërisë.*

# 5.4 Shëndetësia

### Teoria e ndryshimit:

**Nëse të gjithë qytetarët (përfshi grupet e cënueshme) sillen në mënyrë më të shëndetshme, angazhohen në kujdesin e tyre shëndetësor dhe kërkojnë akses në shërbime shëndetësore cilësore, atëherë sistemi i kujdesit shëndetësor parësor, përshi kujdesin në rast emergjence, do të përshtatet me nevojat e popullsisë dhe shëndeti i qytetarëve do të përmirësohet sepse një qasje llogaridhënëse, e decentralizuar dhe gjithëpërfshirëse i përgjigjet në mënyrë mjaft efektive nevojave shëndetësore të qytetarëve.**

Gjatë punës drejt këtij rezultati të portofolit, bashkëpunimi zviceran synon të përmirësojë efikasitetin, mbulimin dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor (përshi edhe për rastet e emergjencave dhe sidomos për grupet e cënueshnme) dhe të promovojë sjelljet e shëndetshme te fëmijët dhe adoleshentët. Mbështetja ka në shënjestër qasjet që synojnë kalimin drejt kujdesit shëndetësor me në qendër njerëzit. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor do të ndihmojë rritjen e kërkesës për shërbime shëndetësore cilësore. Si donatori dypalësh më i madh i Shqipërisë në sektorin e shëndetësisë, Zvicra do të mbështesë hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare shëndetësore me pjesëmarrje, si dhe do të promovojë angazhimin e qytetarëve, shoqërisë së organizuar civile dhe sektorit privat vendor e kombëtar. Angazhimi proaktiv në dialogun për politikat do të përmirësojë transparencën e financimit të shëndetësisë dhe koordinimin e mbështetjes së jashtme për sektorin. Zërat e pacientëve dhe institucioneve të pavarura do të forcohen për t'u kërkuar llogari shërbimeve shëndetësore.

*Qytetarët e fuqizuar gëzojnë akses të drejtë në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor*

- Rezultati 4.1: Njerëzit përqafojnë stile jetese më të shëndetshme në një mjedis që nxit përmirësimin e shëndetit.
- Rezultati 4.2: Sistemi shëndetësor ofron akses të përmirësuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, me elasticitet të përmirësuar dhe gatishmëri të përmirësuar për emergjenca.



*Infermier i trajnuar me mbështetje zvicerane duke dhënë kujdes në shtëpi për pacientë në fshatrat e largët të qarkut Dibër.*

Fëmijët dhe adoleshentët do të sillen në mënyrë më të shëndetshme dhe do të ndërgjegjësohen rreth ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe mjedisit në shëndet, kjo falë mbështetjes së komuniteteve dhe bashkive. Situata kritike e punonjësve të shëndetësisë do të përmirësohet, falë politikave të qarta për burimet njerëzore dhe nëse është e mundur, edhe angazhimit të diasporës. Institucionet kombëtare publike që shihen si motorë të ndryshimit do të marrin mbështetje për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të decentralizuara dhe gjithëpërfshirëse, sidomos në fushën e emergjencës. Mundësitë shëndetësore digjitale do të mbështeten sistematikisht, me fokus te praktikat që përputhen me kontekstin (si modelet e kujdesit në shtëpi, e-konsultimi dhe promocioni shëndetësor) dhe te përmirësimi i aksesit dhe gjithëpërfshirjes së më të cënueshmëve (p.sh të moshuarit, komuniteti rom dhe gratë). Shëndeti mendor do të trajtohet nga të gjitha ndërhyrjet.

## 5.5 Temat tej-përshkuese

Programi i bashkëpunimit zviceran përpiqet të integrojë të gjitha temat dhe tematikat e rëndësishme. Gjinia, gjithëpërfshirja dhe qeverisja janë tema që janë integruar sistematikisht në analizën, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha ndërhyrjeve zvicerane. Për sa i përket qeverisjes, Zvicra nxit parimet kryesore të pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies. Të gjithë partnerët tanë, përfshi edhe OShC-të, sektori privat dhe institucionet e pavarura, nxiten dhe mbështeten të përmirësojnë politikat dhe veprimet e tyre për qeverisjen e mirë, përfshi edhe masat kundër korrupsionit dhe pro integritetit.

Krahas kësaj, Zvicra ndërmerr vlerësime sistematike dhe aktive për të parë nëse ndërhyrjet mund të trajtojnë tema të tjera strategjike ndërsektoriale – midis të tjerave ndryshimet klimatike, digjitalizimi, elasticiteti,, migracioni dhe përballja me të shkuarën, ndër të tjera (duke marrë parasysh ndikimin në qeverisje). Trajtimi ose jo i këtyre temave varet nga mundësitë, disponueshmëria e fondeve (të lakueshme) dhe parimi i qasjes së fokusuar. Digjitalizimi nënkupton përqendrimin e vëmendjes te aksesi për të gjithë dhe mbrojtja e të dhënave.

**Arti dhe kultura** janë të rëndësishme për zhvillimin njerëzor. Lidhjet e shumta midis kulturës dhe zhvillimit shihen dhe përfshihen si faktor i punës së Zvicrës drejt zhvillimit. Për pasojë, Ambasada e Zvicrës do të ndihmojë nxitjen e skenës së pavarur kulturore në Shqipëri dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal me aktorët kulturorë në Ballkanin Perëndimor. Nga buxheti total operacional i SDC-së 2022-2025 për Shqipërinë, 1% do t'i dedikohet mbështetjes për nismat kulturore vendore dhe artistët.



*Bumi i ndërtimeve në Tirana i parë nga sytë e artistit të ri Blerim Tuzi. Betonuza: 'Çdokush dhe çdo gjë që i hedh sytë, kthehet në beton'.*

# 6. Menaxhimi i zbatimit të programit të bashkëpunimit

Zvicra synon të forcojë institucionet shqiptare dhe t'i ndihmojë ato të bëhen më transparente dhe efektive. . Programi i bashkëpunimit zviceran do të rrisë diversitetin e partnerëve të tij për të forcuar e vendimmarrjen demokratike dhe për të përmirësuar sistemin e kontrolleve dhe balancave , veçanërisht nëpërmjet mbështetjes për procedurat e konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve. Programi do t'i kushtojë vëmendje forcimit të partneriteteve me sektorin privat, OShC-të, lëvizjet dhe qytetarët -qofshin individë apoe grupe. Me të gjithë partnerët Ambasada e Zvicrës do të hartojë më tej masa kyçe për politika ku do të ndërthuren diplomacia, angazhimi politik dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Mesazhet politike dhe ato për politika do të përditësohen vazhdimisht për të pasqyruar ndryshimet kontekstuale dhe do t'u komunikohen audiencave të synuara.

Zvicra promovon mekanizma konsultimi dhe koordinimi midis aktorëve kombëtarë, rajonale dhe vendorë për të nxitur dialogun konstruktiv. Ambasada e Zvicrës gjithashtu do të ofrojë informacion mbi disponueshmërinë e ekspertizës zvicerane për aktorë shqiptarë. Krahas kësaj, mund të mbështesë shkëmbime midis kolegëve, bazuar në kërkesën dhe nëse kjo shërben si burim frymëzimi, dhe mund të forcojë lidhjet me diasporën shqiptare, sipas mundësive.

Si një donator dypalësh i rëndësishëm për Shqipërinë, Zvicra nxit mekanizmat e koordinimit të donatorëve dhe angazhohet veçanërisht në AFP, decentralizim dhe shëndetësi. Zvicra përdor një qasje fleksible, bazuar në faktorë të tillë si lidershipi nga ana e QSh-së dhe përfshirja e institucioneve ndërkombëtare, e cila mund të ndikojë te përzgjedhja e temave. Zvicra i jep mjaft prioritet promovimit të përfshirjes së shoqërisë civile në platformat e koordinimit.

Për sa i përket modaliteteve të ndihmës, Zvicra merr gjithnjë në konsideratë përdorimin e sistemit të vendit, bazuar në tregues të performancës të dakorduar paraprakisht, dhe në masa kundër korrupsionit. Në parim, Zvicra përdor edhe qasjet të bazuara në performancë, duke i parë pronësinë dhe llogaridhënien si elemente kyçe të një partneriteti të frytshëm. Mundësitë për bashkëfinancim me aktorët shtetërorë në nivel qendror dhe vendor, bashkërendimi i ndërhyrjeve me shumë partnerë dhe angazhimi i sektorit privat janë më se të mirëpritur. Do të merret në konsideratë edhe mbështetja institucionale për të siguruar një kuadër mundësues për aktorët joshtetërorë (si OShC-të, organizatat rinore dhe sektori privat). Programi i bashkëpunimit do të synojë ekuilibrin midis rezultateve transformuese afatgjata dhe përmirësimeve afatshkurtra.

Bashkëpunimi me organizatat shumëpalëshe do të realizohet në nivel politikash dhe nivel operacional. Kur shihet e përshtatshme, programi i bashkëpunimit do të kërkojë përpjekje të përbashkëta në kuadër të dialogut për politikat, duke u mbështetur te bashkëpunimi i ngushtë i OKB-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare me QSh-në. Zvicra i sheh ndërhyrjet shumëpalëshe si të favorshme, sidomos si mundësi për projekte me shumë partnerë. Vlefshmëria e mbështetjes zvicerane është kriteri kryesor për të vendosur mbi angazhimin me organizata shumëpalëshe.

Mund të ketë ndryshime të rëndësishme kontekstuale gjatë muajve dhe viteve të ardhshme (shihni analizën kontekstuale), gjë që kërkon përshtatje të ndërhyrjeve me zhvillimet e ardhshme dhe analizë politiko-ekonomike. Novacione lidhur me modalitetet e ndihmës dhe lloje të reja të partneriteteve (që përfshijnë sektorin privat, qytetarët etj.) mund të justifikojnë ndërmarrjen e disa risqeve, të cilat do të monitorohen nga afër dhe do të zbuten.

# 7. Drejtimi strategjik i programit të bashkëpunimit

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri e realizon drejtimin strategjik të programit të bashkëpunimit përmes instrumenteve dhe proceseve të mirëpërcaktuara. Sistemi aktual i monitorimit siguron drejtim të orientuar drejt rezultateve, përfshi llogaridhënien dhe komunikimin, dhe mundëson ndërkohë menaxhim përshtatës në një kontekst dinamik. Sistemi i monitorimit përfshin katër nivele vëzhgimi: (i) kontekstin, (ii) rezultatet e portofolit zviceran (efektiviteti), (iii) zhvillimin e vendit (efektiviteti) dhe (iv) menaxhimin e programit. Monitorimi i zhvillimit të vendit do të marrë parasysh edhe qasjen e bazuar te të drejtat e njeriut, sikurse shprehet nga treguesit e Rishikimit Periodik Universal të axhendës së OKB-së për të drejtat e njeriut dhe sikurse përfshihet pjesërisht në kuadrin tonë të rezultateve.

Kuadri i rezultateve (Shtojca 2) është instrumenti kryesor i monitorimit dhe drejtimit të orientuar ndaj rezultateve. Kuadri përshkruan qartësisht treguesit e rezultateve tepër ndryshimet e synuara dhe shfaq kontributin e programit për rezultatet e zhvillimit të Shqipërisë, për Strategjinë Zvicerane të Bashkëpunimit Ndërkombëtar 2021-2024 si dhe për Axhendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Burimet e të dhënave për treguesit e rezultateve përfshijnë statistikat kombëtare dhe raportet monitoruese kur janë të disponueshme, si dhe sistemin monitorues të projekteve dhe vlerësimet e raportet periodike të partnerëve të zhvillimit.

Informacioni nga vlerësimet vjetore kumulative të kuadrit formon raportet vjetore të rezultateve. Procesi i raportimit vjetor (RV) fokusohet te efektiviteti i objektivave të Portofolit Zviceran (kundrejt zhvillimit të vendit, ekzekutimit të buxhetit dhe aspekteve financiare), si dhe te implikimet e mësimet e nxjerra. Raporti vjetor gjithashtu pasqyron analizën, implikimet për drejtimin dhe përshtatjet e mundshme që dalin nga Rishikimi Mesvjetor (MYR)) dhe nga vlerësimi vjetor i skenarëve dhe kontekstit të zhvillimit, që përdor Sistemin e Monitorimit të Ndryshimeve të Lidhura me Zhvillimin (MERV).

Instrumentet dhe mekanizmat e përdorura për monitorimin e supozimeve, risqeve, mundësive dhe skenarëve përfshijnë Vlerësimet e Riskut nga Partnerët, Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, mbledhjet e Komiteteve Drejtues, vizitat në terren dhe shkëmbime të rregullta me palët, si dhe raportet vjetore e ato të fazave nga partnerët zbatues për menaxhimin e të riskut..

Të nxënit është pjesë e procesit të raportimit vjetor dhe forcohet më tej përmes shkëmbimeve të brendshme, si mbledhjet e Komiteteve Operacionale dhe aktiviteteve specifike, përfshi takime rajonale dhe misionet/vizitat në terren. Pandemia COVID-19 ka rritur rëndësinë e monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave në distancë. Temë tjetër me interes në lidhje me të nxënit, ka të bëjë me lidhjet midis bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve diplomatike. Organizatat rinore do të luajnë rol në monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimeve kontekstuale.

Drejtimi i Programit të Bashkëpunimit 2022-2025 kërkon fleksibilitet dhe lakueshmëri, pasi ka të bëjë me përgjigjen sistematike ndaj fatkeqësive të njëpasnjëshme të tërmetit të 2019-s dhe pandemisë së COVID-19, dhe reagon ndaj prioriteteve që QSh-ja e re ka duke nisur nga 2022 , ndaj dinamikave të procesit të anëtarësimit në BE dhe Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI). Prandaj drejtimi i programit do të trajtohet gjatë procesit të raportimit vjetor për 2022-shin. Kjo gjë do të përfshijë edhe vendime bazuar tek vlerësimet dhe përfundimet lidhur me drejtimin, veçanërisht në fushën e qeverisjes demokratike (mbështetje parlamentare dhe zhvillim rajonal). Në vitin 2023 do të vendoset nëse Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri do t'i nënshtrohet apo jo vlerësimit të programeve nga njësitë e vlerësimit të SDC-së dhe SECO-s.

# Shtojca 1: Përmbledhje e kuadrit të rezultateve (portofoli zviceran)

**Kontribut për demokraci funksionale, institucione dhe shërbime publike efektive; një ekonomi tregu të qëndrueshme, përfshirëse dhe konkurruese; zbutje të ndryshimeve klimatike dhe për arritjen dhe zbatimin e standardeve dhe vlerave evropiane**

| **Qeverisja demokratike** | **Ekonomia dhe vendet e punës** | **Shërbimet e infrastrukturës dhe ndryshimet klimatike** | **Shëndetësia** |
|---|---|---|---|
| Njerëzit përfitojnë nga institucionet përfshirëse, të efektshme dhe demokratike | Njerëzit kontribuojnë për dhe përfitojnë nga rritja e qëndrueshme ekonomike, mundësitë më të mëdha për biznes dhe vendet e përshtatshme të punës | Njerëzit përfitojnë nga aksesi i përmirësuar në shërbime të qëndrueshme infrastrukture ekonomike dhe nga trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe efekteve të tyre | Qytetarët e fuqizuar kanë akses të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore |
| **Rezultati 1:** Institucionet publike nën-kombëtare ofrojnë shërbime efektive për të gjithë shqiptarët, duke përfshirë më të cënueshmit<br><br>**Rezultati 2:** Kuvendi dhe këshillat bashkiakë përmirësojnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, ligjvënëse dhe të përfaqësimit.<br><br>**Rezultati 3:** Qytetarët dhe shoqëria civile e organizuar fuqizojnë angazhimin e tyre në përcaktimin e agjendave dhe në vendimmarrje, si dhe u kërkojnë llogari institucioneve publike | **Rezultati 1:** Një kuadër makroekonomik i besueshëm përmirëson aftësinë e rimëkëmbjes, ofrimin e shërbimeve dhe rrit besimin e qytetarëve dhe bizneseve për të konsumuar dhe investuar.<br><br>**Rezultati 2:** Një mjedis biznesi miqësor me novacionin kontribuon drejt konkurrueshmërisë më të lartë, investimeve produktive dhe mundësive për punësim.<br><br>**Rezultati 3:** Punësueshmëria e njerëzve (të rinjve) përmirësohet përmes zhvillimit të aftësive që kërkon tregu dhe shërbimeve efektive të tregut të punës | **Rezultati 1:** Njerëzit përfitojnë nga shërbime të besueshme dhe të përballueshme të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta që ofrohen nga institucione publike efektive.<br><br>**Rezultati 2:** Autoritetet kombëtare dhe vendore menaxhojnë energjinë në mënyrë të qëndrueshme për të ndihmuar me zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe për t'i mbështetur qytetet dhe komunitetet të bëhen më rezistente ndaj rreziqeve natyrore. | **Rezultati 1:** Njerëzit ndjekin stile jetese më të shëndetshme në një mjedis që favorizon shëndetin<br><br>**Rezultati 2:** Sistemi shëndetësor ofron akses të përmirësuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor me përmirësim të aftësisë së rimëkëmbjes dhe përgatitjes në rast emergjencash |
| Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Zvicrës Nënobjektivat*: (3) (7) dhe (10) | Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Zvicrës Nënobjektivat (1 ) dhe (2) | Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Zvicrës Nënobjektivat: (3), (6) dhe (7) | Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Zvicrës Nënobjektivat: (7) dhe (10) |
| **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm:** 3 Good health and well being; 10 Reduced inequalities; 16 Peace, justice and strong institutions | **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm:** 1 No poverty; 8 Decent work and economic growth; 9 Industry, innovation and infrastructure | **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm:** 6 Clean water and sanitation; 7 Affordable and clean energy; 13 Climate action | **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm:** 3 Good health and well being |

**Tema tej-përshkuese: Gjinia, Përfshirja sociale, Qeverisja**

*Nënobjektivat e Strategjisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Zvicrës ndaj të cilave kontribuon Programi për Bashkëpunim me Shqipërinë:

(1) Fuqizimi i kushteve kuadër për aksesin në treg dhe krijimin e mundësive ekonomike
(2) Promovimi i nismave novatore të sektorit privat për lehtësimin e krijimit të vendeve të përshtatshme të punës
(3) Trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe efekteve përkatëse
(6) Parandalimi i fatkeqësive dhe sigurimi i rindërtimit dhe rehabilitimit
(7) Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbime cilësore bazë
(10) Promovimi i qeverisjes së mirë dhe shtetit të së drejtës, si dhe fuqizimi i shoqërisë civile

# Shtojca 2: Kuadri i rezultateve për portofolin zviceran

<table>
<tr><th colspan="3">Qeverisja demokratike (SDC/SECO)</th></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultati 1 i Portofolit Zviceran: Njerëzit përfitojnë nga institucionet përfshirëse, të efektshme dhe demokratike.</td></tr>
<tr><td>Jep kontribut për:</td><td colspan="2">Nën-objektivin Nr. 3: Trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe ndikimeve të tyre;<br>Nën-objektivin Nr. 7: Forcimi i qasjes sipas nevojës në shërbime bazë me cilësi të lartë;<br>Nën-objektivin Nr. 10: Nxitja e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit dhe forcimi i shoqërisë civile.</td></tr>
<tr><th>(1) Rezultatet e Portofolit Zviceran</th><th>(2) Kontributi i Programit Zviceran</th><th>(3) Rezultatet e Zhvillimit të Vendit</th></tr>
<tr><td>Deklarata e rezultatit 1: Institucionet publike nën-kombëtare ofrojnë shërbime efektive për të gjithë shqiptarët, përfshirë ata më të cënueshmit.<br><br>Treguesit:<br>1) Pjesëmarrja e publikut: Numri i njerëzve që marrin pjesë në dhe ndikojnë ofrimin e shërbimeve publike, vendimmarrjen dhe buxhetin në vendbanimet e tyre (GOV_ARI 1,)<br>Baza fillestare (2020): 7.110 njerëz morën pjesë në 32 anketime në internet, dhe mesatarisht 130 persona marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes (40% F) në 33 bashki<br>Synimi (2025): 20% më shumë njerëz (50% F) në 61 bashki<br><br>2) Menaxhim i besueshëm publik: Numri i bashkive që hartojnë (a) buxhete realiste të bazuara në performancë, (b) rritje të të ardhurave vendore dhe (c) raporte financiare në përputhje me kërkesat<br>Baza fillestare (2020): (a) 28 NJQV (b) 18 NJQV (c) 18 NJQV<br>Synimi (2025): (a,b,c) 61 NJQV<br><br>3) Mbrojtja sociale: Pjesa e popullsisë së mbrojtur të paktën në një zonë të mbrojtjes sociale (POV TRI 2); qasje e përmirësuar në shërbime shoqërore.<br>Baza fillestare (2021): 187.630 persona të cënueshcënueshëm (+50% F) që jetojnë në 25 NJQV<br>Synimi (2025): 350.000 persona të cënueshcënueshëm (+50% F) që jetojnë në 30 NJQV</td><td>Zvicra mbështet forcimin e kapaciteteve bashkiake për hartimin e buxheteve dhe raporteve për performancën e shërbimeve, bazuar në të dhëna të besueshme për vendimmarrje, dhe për komunikimin e tyre qytetarëve në mënyrë transparente përmes një formati të digjitalizuar dhe miqësor me përdoruesin.<br>Zvicra mbështet ofrimin më të mirë të shërbimeve të përzgjedhura.<br><br>Zvicra mbështet ofrimin e shërbimeve shoqërore të decentralizuara dhe të integruara dhe është e aftë të sigurojë përfshirjen e të gjithë grupeve dhe personave të cënueshcënueshëm në Shqipëri.<br><br>Supozimet:<br>• Shërbimet janë të financuara në mënyrë të përshtatshme.<br>• Administrata forcon kapacitetet e saj të ofrimit.<br><br>Risqet:<br>• Ka mungesë vullneti për të vijuar decentralizimin e përgjegjësive dhe burimet në nivelin vendor.</td><td>Deklarata e rezultatit 1: Cilësia e shërbimeve publike të ofruara nga qeverisja vendore përmirësohet dhe përshkallëzohet (Strategjia e Decentralizimit)<br><br>Treguesit:<br>1) Kënaqësia e qytetarëve me shërbimet publike<br>Baza fillestare (2020): 64% (Hartëzimi i Qeverisjes Vendore 2020)<br>Synimi (2025): 72% (Hartëzimi i Qeverisjes Vendore 2025)<br><br>2) Financa vendore të forcuara dhe autonomi e shtuar fiskale, përmes konsolidimit të sistemit të të ardhurave vendore dhe forcimit të sistemit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.<br>Baza fillestare (2021): vendoset në qershor 2022,<br>Synimi (2025): vendoset në qershor 2022 (Burimi) Strategjia e Decentralizimit dhe Strategjia e MFP)<br><br>3) Fillimi i zbatimit të grupit të plotë të masave të decentralizuara të mbrojtjes sociale për parandalimin e varfërisë dhe reduktimin e pabarazive pritet të arrihet deri në vitin 2024.<br>Baza fillestare e varfërisë (2018): 23,4%<br>Synimi i varfërisë:<br>Koeficienti Gini Baza fillestare (2018): 35,4%<br>Koeficienti Gini Synimi (2025): sipas përditësimeve periodike të BE-SILC<br>Baza fillestare e mbulimit me shërbime shoqërore (2021): 50% e popullatës<br>Synimi (2025): për t'u vendosur në bazë të dokumentit të ri të politikës për përfshirjen sociale</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **Deklarata e rezultatit 2:** Parlamenti dhe këshillat bashkiakë përmirësojnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, ligjbërëse dhe të përfaqësimit<br><br>**Treguesit**<br>1) Përfaqësimi demokratik: Pjesa e qytetarëve të kënaqur me parlamentin e tyre (të kategorizuar sipas gjinisë, GOV TRI 1)<br>Baza fillestare (2019): Besimi tek parlamenti 28% (M: 30% - F: 28%)<br>Synimi (2025): Besimi tek parlamenti 40% (M: 40% - F: 40%) (Burimi: Anketimi Besimi tek Qeverisja)<br><br>2) Numri i vendimeve të këshillave bashkiakë që i përgjigjen nismave qytetare (p.sh. peticioneve, ankesave, nismave qytetare, kërkesave, etj.)<br>Baza fillestare (2020): 48 bashki kanë regjistruar 402 kërkesa; 160 kërkesa kanë marrë përgjigje nga këshillat përkatës; dhe 25% e kërkesave janë pasqyruar në vendimet e këshillave.<br>Synimi (2025): 10% më shumë kërkesa të pasqyruara në vendimet e këshillave të të 61 bashkive | Zvicra ndihmon në mëkimin e kontrollit dhe balancave duke forcuar funksionet bazë të parlamentit në nivel kombëtar dhe të këshillave bashkiakë.<br><br>Supozimet:<br>• Parlamenti dhe këshillat bashkiakë rreken të forcojnë kapacitetet dhe mekanizmat e tyre të brendshëm, dhe bëhen më transparentë dhe përfshirës.<br>• Institucionet e pavarura të përzgjedhura janë të gatshme të luajnë rolin e tyre.<br><br>Risqet:<br>• Interesat partiakë pengojnë parlamentin dhe këshillat bashkiakë në kryerjen e funksioneve të tyre bazë.<br>• Institucionet e pavarura nuk janë të afta/të gatshme të hartojnë raporte të pavarura. | **Deklarata e rezultatit 2:** Ligjbërja cilësore dhe kontrolli i fuqishëm parlamentar më pranë qytetarëve, sigurohen për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin evropian të Shqipërisë.<br><br>**Treguesit:**<br>1) Parlamenti zbaton planin strategjik.<br>Baza fillestare (2021): 0%<br>Synimi (2025): 75% e masave të planit strategjik janë zbatuar<br><br>2) Rregullat dhe procedurat e këshillave bashkiakë janë të përcaktuara dhe në zbatim të plotë.<br>Baza fillestare (2020): 40 këshilla bashkiakë<br>Synimi (2025): 61 këshilla bashkiakë |
| **Deklarata e rezultatit 3:** Qytetarët dhe shoqëria civile e organizuar forcojnë angazhimin e tyre në përcaktimin e agjendës dhe në vendimmarrje, dhe i kërkojnë institucioneve llogari.<br><br>**Treguesit:**<br>1) Pjesëmarrja demokratike dhe qasja në informacion: Pjesa e njerëzve që besojnë se janë të informuar më mirë dhe kanë më shumë zë, në sajë të nismave të shoqërisë civile të mbështetura, apo medias për interes publik (GOV TRI 2).<br><br>Baza fillestare (2021): 56,5%<br>F: 50% dhe 23% LNOB (50% F)<br>Synimi (2025): 65%<br>F: 50% dhe 25% LNOB (50% F)<br>Burimi: Programi për mbështetjen e shoqërisë civile<br><br>2) Hapësira për shoqërinë civile: Numri i organizatave të shoqërisë civile që japin kontribut në dialogun me shumë palë interesi, ose për respektimin e të drejtave të njeriut (FCHR_ARI_1)<br>Baza fillestare (2020): 7<br>Synimi (2025): 20<br>Burimi: Projekti për Mbështetjen e Shoqërisë Civile | Zvicra jep kontribut për demokraci dhe sistemi kontrolli dhe balancash të përmirësuar, përmes mbështetjes së aktorëve qytetarë, përfshirë median, në veprimet e tyre që ndikojnë në përcaktimin e përparësive, vendimmarrjen, dhe llogaridhënien e autoriteteve qeveritare. Nismat e suksesshme japin kontribut në rritjen e besimit tek institucionet.<br><br>**Supozimet:**<br>• Ka vullnet të përgjithshëm politik për të siguruar një mjedis të favorshëm për angazhimin qytetar dhe atë të OSHC-ve.<br>• Ka vullnet të përgjithshëm politik për të siguruar një mjedis të favorshëm për angazhimin qytetar dhe atë të OSHC-ve.<br><br>**Risqet:**<br>• Vijon prirja drejt politizimit të shoqërisë civile dhe medias.<br>• Apatia politike dhe zhgënjimi i përgjithshëm i popullsisë pengojnë mobilizimin e qytetarëve.<br>• Liria e kufizuar e medias përkeqësohet.<br>• QSH tregon një mungesë vullneti lidhur me angazhimin në dialog konstruktiv. | **Deklarata e rezultatit 3:** Shoqëria civile aktive, kritike dhe konstruktive siguron një përbërës thelbësor të një demokracie pluraliste, që i lejon qytetarëve të organizohen lirisht në grupe interesi dhe të marrin pjesë në procesin e ciklit të politikave dhe vendimmarrjes së vendit të tyre në mënyrë të rregulluar dhe transparente. (Udhërrëfyesi për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023)<br><br>**Treguesit:**<br>1) Zbatimi i Udhërrëfyesit për Politikat Qeveritare për një Mjedis më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023<br>Baza fillestare (2020): Nuk ka progres<br>Synimi (2023) 50% e masave të nisura ose në progres<br>(Burimi: Progres Raporti i BE-së)<br><br>2) Liritë themelore: Zbatimi i rekomandimeve për masa të efektshme për forcimin e lirisë së mendimit dhe shprehjes së medias, dhe për të sigurimin e një mjedisi më të sigurt për gazetarët.<br>Baza fillestare (2020): 3 rekomandime<br>Synimi (2025): 3 rekomandime të zbatuara<br>(Burimi: Shqyrtimi Periodik Universal i OKB-së për të Drejtat e Njeriut) |

**(4) Linjat e veprimtarisë (Programi Zviceran)**

**Teoria e ndryshimit:**

**Nëse** qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile organizohet, angazhohen në përcaktimin e agjendës dhe vendimmarrje, dhe i kërkojnë llogari institucioneve publike, dhe nëse institucionet publike legjislative dhe ekzekutive janë të gatshme dhe të afta të përgjigjen, **atëherë** parlamentet dhe këshillat vendorë do të kryejnë funksionet e tyre bazë, dhe do të përmirësohet qeverisja demokratike dhe ofrimi përfshirës i shërbimeve, **sepse** një shoqëri civile aktive, kritike dhe konstruktive dhe institucione llogaridhënëse janë përbërës thelbësorë të një demokracie pluraliste.

- Mbështetje për bashkitë për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në fushat kyçe të MFP, bazuar në prova lidhur me shpenzimet publike dhe llogaridhënien financiare (PEFA).
- Mbështetje për bashkitë për garantimin e komunikimit transparent lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe përmirësimin gjithëpërfshirës të shërbimeve të arsimit parashkollor.
- Forcimi i aftësive të bashkive për të menaxhuar në mënyrë efikase shërbimet shoqërore dhe për të promovuar përfshirjen sociale, dhe të aftësive të qeverisjes qendrore për të zbatuar kuadrin e politikave për ofrimin dhe financimin e shërbimeve shoqërore.
- Mbështetje për krijimin dhe zhvillimin e sistemeve rajonale dhe vendore të statistikave (regjistrim bazuar në funksion).
- Mbështetje për këshillat bashkiakë dhe parlamentin kombëtar për kryerjen e funksioneve të tyre bazë, si përfaqësimi, legjislacioni dhe mbikëqyrja. Kjo do të thotë forcim të administratës së parlamentit si dhe njohuri nga ana e deputetëve dhe këshilltarëve në parlament për tema të përzgjedhura. Këshillat bashkiakë të fuqizuar kanë komisione aktive të gjinisë dhe përfshirjes sociale (aleancat e grave), dhe veprojnë me pjesëmarrjen qytetare.
- Mbështetje për institucionet e pavarura për dorëzimin në parlament të raporteve të bazuara në prova (vendoset në 2022).
- Forcohen qytetarët, lëvizjet dhe OSHC-të (me organizim formal ose jo), duke mbështetur shtysat për ndryshim që po kërkojnë integrimin e tyre në vendimmarrje, llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve publike, si dhe për formulimin e propozimeve konkrete për zhvillim.
- Mbështetje për fuqizimin e personave të cenueshëm, që të gëzojnë qasje të barabartë në mundësi dhe të kenë zërin e tyre lidhur me vendimet që ndikojnë jetën e tyre.
- Mbështetje për bashkitë që të jenë më llogaridhënëse ndaj qytetarëve dhe t'i përfshijnë ata në vendimmarrje, përfshirë konsultimet publike për buxhetet bashkiake.

**(5) Burimet, partneritetet (Programi Zviceran)**

Buxheti: 36,8 milion CHF (Franga zvicerane) (SDC 32,8 milion CHF; SECO 4 milion CHF për MFP në nivel nënkombëtar)

Partnerët publikë kryesorë do të jenë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Parlamenti, Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, INSTAT, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Shoqatat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, institucione të pavarura të përzgjedhura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Shoqëria civile, organizatat vendore dhe kombëtare do të mbështeten, ashtu si edhe lëvizjet, grupet e qytetarëve dhe individët. Vazhdimësia e mundshme e partneriteteve me UNDP-në, dhe OSBE-në do të vlerësohet bazuar në rezultatet dhe respektimin e rregullave administrative të SDC-së.

Sa i përket modaliteteve dhe llojeve të partneriteteve, mandatet duhet të ulen dhe kontributet duhet të merren fillimisht në konsideratë për institucionet publike, por edhe për OJF-të vendore. Mund të përdoren veprime të vogla për të përforcuar koherencën ndërmjet mesazheve politike dhe ndërhyrjeve. Bashkëdrejtimi i grupit të punës për decentralizimin me BE-në do të vijohet, dhe duhet të merret në konsideratë një rol më aktiv në grupin e punës të OSHC-ve, bazuar në mundësitë përkatëse.

**(6) Rezultatet e menaxhimit/performancës, përfshirë treguesit (Programi Zviceran)**

- Vendimi për mbështetjen e mundshme të zhvillimit rajonal do të merret në janar të vitit 2022. Mund të përcaktohet një temë e re ndërhyrjeje në SPO 1 (p.sh. antikorrupsioni).
- Mbështetja për OSHC-të do të shtohet dhe zgjerohet për të a) përforcuar efektin plotësues të ndërthurjes së mesazheve politike, dialogut për politikat dhe ndërhyrjeve dhe b) përfshirë aktorë të rinj (p.sh. lëvizje, kontribute strategjike për OJF-të kombëtare).
- Mbështetja për parlamentin mund të përfshijë aktorë të jashtëm shtesë (p.sh. institucionet e pavarura), që plotësojnë mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimi me partnerët aktualë mund të ripërkufizohet ose përshtatet.
- Mesazhet politike për qeverisjen demokratike do të përditësohen vazhdimisht me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në kontekst dhe do t'i komunikohen audiencave të synuara përkatëse.

| **Zhvillimi ekonomik dhe punësimi (SECO dhe SDC)** | | |
|---|---|---|
| **Rezultati 1 i Portofolit Zviceran:** Njerëzit japin kontribut për, dhe përfitojnë nga, rritja ekonomike, më shumë mundësi për biznes dhe më shumë punë dinjitoze. | | |
| *Jep kontribut për:* | **Nën-Objektivi Nr. 1:** *Forcimi i kushteve kuadër për qasjen në treg dhe krijimin e mundësive ekonomike;*<br>**Nën-objektivi Nr. 2:** *Promovimi i nismave novatore ne sektorin privat për të lehtësuar hapjen e vendeve dinjitoze të punës.* | |
| **(1) Rezultatet e Portofolit Zviceran** | **(2) Kontributi i Programit Zviceran** | **(3) Rezultatet e Zhvillimit të Vendit** |
| **Deklarata e rezultatit 1:** Një kuadër i besueshëm makroekonomik përforcon aftësinë ripërtëritëse, përmirëson ofrimin e shërbimeve dhe rrit besimin e qytetarëve dhe bizneseve për të konsumuar dhe investuar.<br><br>**Treguesit:**<br>1) Masa për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe institucional (SECO SI 1)<br>Baza fillestare (2020): për masat e MFP treguesit dhe pikëzimi i PEFA; për masat e administratës tatimore, treguesit dhe pikëzimi i TADAT<br>Synimi (2025): Tregues dhe pikëzim i përmirësuar i PEFA[4] dhe TADAT<br><br>2) Masat për përmirësimin e stabilitetit financiar dhe zhvillimin e tregut (SECO SI 3)<br>Baza fillestare (2021): Kapacitetet e mira të Bankës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave të kujdesshme në nivel makro për parandalimin e risqeve që kërcënojnë stabilitetin financiar dhe për të rritur qëndrueshmërinë e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; tregu i kapitalit është pak i zhvilluar, dhe nuk ka thellësi dhe diversifikim, ndërsa përfshirja financiare është në nivelet më të ulëta në rajonin e Ballkanit.<br>Synimi (2025): Kapacitete të përmirësuara të Bankës së Shqipërisë në fushën e stabilitetit financiar; tregu i kapitalit zgjerohet për shkak të rritjes dhe diversifikimit të ofertës dhe më specifikisht të konsumatorëve me edukim financiar (veçanërisht bizneset e vogla dhe familjet). | Zvicra mbështet forcimin e institucioneve shqiptare për arritjen e gjendjes së besueshme dhe të qëndrueshme makroekonomike dhe një tregu të qëndrueshëm financiar dhe të kapitalit.<br><br>**Supozimet:**<br>• Reformat për stabilitetin makroekonomik dhe fiskal përparojnë me ritëm të qëndrueshëm.<br>• Sektori financiar mbetet i qëndrueshëm në përgjithësi, ndërsa tregu i kapitalit vijon të zgjerohet dhe zhvillohet.<br><br>**Risqet:**<br>• Risqet fiskale vijojnë të jenë të pranishme, kryesisht të lidhura me presionin e lartë demografik, borxhin e lartë publik, mbledhjen e ulët të të ardhurave dhe kontigjencat që rrjedhin nga PPP-të; risqet e sektorit financiar lidhen me shkallën e lartë të përdorimit të Euros, numrin e lartë të huave të këqija (NPL) dhe cenueshmërinë sistemike të sektorit jobankar. | **Deklarata e rezultatit 1:** Stabiliteti financiar dhe konvergjenca e qëndrueshme ekonomike arrihen falë një buxheti më të mirëekuilibruar dhe qëndrueshëm, me një raport të reduktuar të borxhit ndaj PBB-së, institucione financiare përgjegjëse dhe një treg të mirëzhvilluar dhe konsoliduar financiar.[5]<br><br>**Treguesit:**<br>1) Borxhi publik dhe deficiti fiskal (raporti me PBB-në)[6]<br>Baza fillestare (2021): 78,6%; -6,5%<br>Synimi (2025): 73,8%, -2%<br>2) Treguesit kyçë të MFP-së<br>Baza fillestare (2021): Sipas strategjisë së MFP-së<br>Synimi (2025): Sipas strategjisë së MFP-së<br>3) Raporti i huave të këqija (NPL), inflacionit, treguesve të tjerë të sistemit financiar<br>Baza fillestare (2021): inflacioni 2,4%; NPL-të 8%<br>Synimi (2025): inflacioni 3%; NPL më të ulëta ('normale' është 2-3%) |

4 Vlerësimi i fundit kombëtar PEFA u krye në 2018 (BB); vlerësimi i fundit TADAT u krye në 2019 (FMN).
5 Burimi: SKZHI 2015–2020 që do të përditësohet me SKZHI-në e re 2022–2030 sapo të jetë e disponueshme.
6 Synimet i referohen vitit 2024; synimi për vitin 2025 do të përcaktohet në pjesën e parë të vitit 2022. Burimi: MFE

| | | |
|---|---|---|
| **Deklarata e rezultatit 2:** Një mjedis biznesi i përmirësuar dhe miqësor me novacionin jep kontribut për konkurrencë më të madhe, investim në prodhimtari dhe mundësi punësimi.<br><br>**Treguesit:**<br>1) Masat për përmirësimin e mjedisit të biznesit[7]<br>Baza fillestare (2021): hendeqet dhe sfidat e identifikuara lidhur me ligjet/rregulloret/procedurat/praktikat/politikat qeveritare<br>Synimi (2025): ligjet/rregulloret/procedurat/praktikat/politikat qeveritare të përmirësuara dhe në zbatim<br>2) Numri i prodhuesve ose shoqërive që kanë qasje në financim dhe që përftojnë qasje në tregje apo zinxhirë të rinj vlerash (SECO SI 12&15)[8]<br>Baza fillestare (2021): 0<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar<br>3) Numri i individëve që kanë punësim të ri ose më të mirë (IED_ARI_2)[9]<br>Baza fillestare (2021): 0<br>Synimi (2025): 4.300 | Zvicra jep kontribut për një mjedis biznesi miqësor me novacionin me qëllim rritjen e konkurrencës, prodhimtarisë dhe investimeve, dhe punon me aktorët publikë dhe privatë për të dhënë kontribut në rritjen e sektorit privat, investimet miqësore me klimën dhe krijimin e vendeve dinjitoze të punës.<br><br>**Supozimet:**<br>• Institucionet publike shqiptare dhe aktorët e sektorit privat janë të angazhuar ndaj parimeve të qeverisjes së mirë ekonomike dhe për përmirësimin e një mjedisi mundësues biznesi, që jep kontribut për një sektor privat konkurrues dhe produktiv.<br>• Qeveria vijon të jetë e angazhuar për zbatimin e reformave në sektorin e punësimit dhe biznesit me qëllim mëkimin e më shumë vendeve dinjitoze të punës.<br><br>**Risqet:**<br>• Rritja ekonomike është e moderuar për shkak të ritmit të ulët të reformës dhe rimëkëmbjes së ngadaltë nga recesioni i shkaktuar nga COVID-19.<br>• Zhvillimi i sektorit privat mbetet nën potencialin e vet për shkak të qasjes së kufizuar në financim, dije dhe tregje. | **Deklarata e rezultatit 2:** Një ekonomi konkurruese e shtyrë më shumë nga novacioni dhe e bazuar në njohuri krijon vende pune të reja me cilësi më të lartë, duke përdorur potencialin e tranzicionit digjital dhe transformimin e zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerave, dhe duke theksuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin në BE dhe atë rajonal.[10]<br><br>**Treguesit:**<br>1) Treguesit kyç të mjedisit të biznesit<br>Baza fillestare (2021): sipas SZHBI-së[11] dhe Planit të Veprimit 2021-27<br>Synimi (2025): sipas SZHBI-së dhe Planit të Veprimit 2021-27<br>2) Shkalla e papunësisë<br>Baza fillestare (2020): 11,7%; papunësia e rinisë 20,9%<br>Synimi (2025): 8,9%; papunësia e rinisë 18% |
| **Deklarata e rezultatit 3:** Punësueshmëria e personave (të rinj) përmirësohet përmes zhvillimit të aftësive përkatëse për tregun dhe shërbimeve efikase të tregut të punës.<br><br>Treguesit:<br>1) Numri i të rinjve (F/M) të regjistruar në zhvillim më të mirë të aftësive profesionale (SDC IED ARI 1) dhe që përfitojnë nga shërbimet e ndërmjetësimit të punës<br>Baza fillestare (2021): 0<br>Synimi (2025): 21.500 (44% f)<br>2) Numri i kontributeve për një sistem AFP-je më përfshirës dhe më afër tregut të punës (SDC IED TRI3) dhe masat të përmirësuara aktive për tregun e punës (MATP).<br>Baza fillestare (2021): (për t'u përcaktuar)<br>Synimi (2025): 1 sistem AFP-je i konsoliduar/i orientuar nga tregu i punës; 1 sistem MATP-je me në qendër individin (për t'u përcaktuar)<br>3) Numri i shoqërive që japin kontribut për zhvillimin e aftësive profesionale përkatëse (SDC IED TRI 2)<br>Baza fillestare (2021): 590 shoqëri presin 2.316 praktikantë (21% f)<br>Synimi (2025): 750 shoqëri presin 4.600 praktikantë (të paktën 25% f) | Zvicra jep kontribut për qasjen e përmirësuar në kapital dhe aftësi, si dhe për zhvillimin e tregjeve të qëndrueshme dhe konkurruese, duke u përqendruar fort në zhvillimin e aftësive dhe atë institucional.<br><br>**Supozimet:**<br>• Qeveria dhe sektori privat mbeten të gatshëm të angazhohen në zbatimin e AFP-së së reformuar dhe për një sistem informacioni të tregut të punës.<br><br>**Risqet:**<br>• Qeveria redukton fondet për zhvillimin e aftësive si pasojë e efekteve të pandemisë.<br>• Dobësia e shoqatave të sektorit privat pengon angazhimin e tyre në AFP.<br>• Palët kryesore të interesit nuk kanë kapacitete për përthithjen e mbështetjes së jashtme dhe/ose për të mirëmbajtur rezultatet e arrira. | **Deklarata e rezultatit 3:** Aftësi të përmirësuara dhe vende pune më të mira për të gjitha gratë dhe burrat[12]<br><br>**Treguesit:**<br>1) Shkalla NEET (jo në arsim, punësim, apo trajnim)<br>Baza fillestare (2021): 25,5% në vitin 2019<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar në kuadër të Strategjisë së re Kombëtare për Aftësi dhe Punësim<br>2) Të papunët e regjistruar që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit<br>Baza fillestare (2021): 20,2% në vitin 2019<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar në kuadër të Strategjisë së re Kombëtare për Aftësi dhe Punësim<br>3) Shkalla e punësimit të të diplomuarve të arsimit profesional<br>Baza fillestare (2021): 45% në vitin 2019<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar në kuadër të Strategjisë së re Kombëtare për Aftësi dhe Punësim |

7 Lidhur me SECO SI 1, por duke iu referuar veçanërisht kushteve kuadër të mjedisit të biznesit.
8 Një nëngrup të dhënash për këtë tregues do të sigurojë informacion për IED_ARI_3 (numri i individëve që kanë qasje në dhe përdorin produktet dhe shërbimet financiare zyrtare).
9 Një nëngrup të dhënash për këtë tregues do të sigurojë informacion për SECO SI 13 (Numri i vendeve të punës të krijuara, të mbajtura ose të përmirësuara).
10 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 (SZHBI)
11 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 (SZHBI)
12 Burimi: Strategjia Kombëtare për Aftësi dhe Punësim 2019-2022, e cila do të përditësohet vitin që vjen.

**(4) Linjat e veprimtarisë (Programi Zviceran)**

**Teoria e ndryshimit**

**Nëse** Shqipëria mbështetet për të konsoliduar një kuadër të besueshëm ekonomik që bëhet shtysë për një sektor më të gjallë, konkurrues dhe produktiv privat dhe nëse punësueshmëria e të rinjve rritet, **atëherë** stabiliteti financiar dhe konvergjenca e qëndrueshme ekonomike do t'i lejojnë ekonomisë të rritet në mënyrë përfshirëse dhe qëndrueshme, **sepse** institucionet publike shqiptare dhe aktorët e sektorit privat krijojnë më shumë vende pune dinjitoze dhe janë të angazhuara ndaj parimeve të qeverisjes së mirë dhe përmirësimit të mjedisit të biznesit.

- Mëkim i dialogut të politikave, përfshirë partnerët e tjerë për zhvillim, që synon mbështetjen e QSH-së për zbatimin e reformave ekonomike dhe advokimin për parimet e qeverisjes së mirë (p.sh. inkurajimin e përdorimit të konsultimeve publike).
- Mbështetje për kapacitetet institucionale të MFP-së në nivel qendror dhe mobilizim të forcuar të burimeve vendase, duke u përqendruar në menaxhimin e borxhit, kontabilitetin publik, mbikëqyrjen e jashtme, administratën tatimore, si dhe rritjen e kapaciteteve dhe performancës institucionale.
- Mbështetje për institucionet shqiptare lidhur me forcimin e aftësive analizuese për financimin e riskut nga fatkeqësitë dhe për t'i ndihmuar ato në identifikimin e përparësive për forcimin e aftësive ripërtëritëse financiare në kuadër të fatkeqësive.
- Në sektorin financiar, mbështetje për i) Bankën e Shqipërisë për hartimin e politikave monetare, stabilitetin financiar dhe kapacitetet kërkimore, dhe ii) Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për rregullore të përforcuara dhe mbikëqyrje të tregjeve të kapitalit dhe sigurimeve.
- Kontribut për politikëbërjen ekonomike të efektshme dhe për mundësimin e mjedisit për bizneset, duke forcuar kapacitetet e institucioneve të sektorit publik dhe privat, dhe duke mbështetur dialogun e bazuar në prova dhe ndarjen e njohurive ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat.
- Konsolidimi i reformës së raportimit financiar të korporatave dhe forcimi i regjimit të pamundësisë paguese për veprimtari më transparente, të besuara dhe efikase të sipërmarrjeve private.
- Përmirësimi i qasjes së sipërmarrësve dhe bizneseve në burime (financim, njohuri dhe teknologji), përfshirë qasjen e diversifikuar në treg (në vend dhe në rang ndërkombëtar), çka jep kontribut për më shumë konkurrencë.
- Forcimi i ofrimit të shërbimeve të institucioneve të sektorit privat dhe organizatave të mbështetjes së biznesit.
- Forcimi i standardeve të cilësisë dhe certifikimit, si dhe sistemeve kombëtare të infrastrukturës së cilësisë, ndërkohë që lehtësohet përputhshmëria e shoqërive (pilot).
- Mbështetje për ekosistemin e sipërmarrjes dhe sipërmarrësit për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për themelimin dhe rritjen e shoqërive që krijojnë më shumë vende dinjitoze pune.
- Kontribut për konsolidimin e sistemit të AFP-së në Shqipëri dhe Masat Aktive të Tregut të Punës duke kopjuar dhe përshkallëzuar modelet e besueshme, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra. Ndërhyrjet përqendrohen në kryesisht agjencitë kombëtare dhe ofruesit përkatës duke përdorur instrumente për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin institucional.

**(5) Burimet, partneritetet (Programi Zviceran):**

Buxheti: 35,1 milion CHF (SDC 17,6 milion CHF; SECO 17,5 milion CHF)

**Partnerët:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, ofruesit publikë dhe privatë të AFP-së dhe aktorë të sektorit privat (si biznese, organizata mbështetjeje/ofrues shërbimesh, organizata të sektorit, përshpejtues dhe inkubatorë).

**Bashkërendimi me partnerët për zhvillim:** FMN, BB, IFC, OKB, GIZ, Delegacioni i BE, BERZH, ADA, Bashkëpunimi Italian.

**(6) Rezultatet e menaxhimit/performancës, përfshirë treguesit (Programi Zviceran)**

- Përforcimi i përqendrimit për përshkallëzimin dhe përsëritjen e përvojave/mësimeve të nxjerra me qëllim arritjen e ndryshimeve sistemike. (Treguesi: Cilësia e shkëmbimeve dhe rastet në të cilat mësimet e nxjerra janë përdorur në vendimet e organeve drejtuese).
- Vlerësimi dhe dhënia përparësi angazhimit në qasje bashkëpunuese, partneriteti ose me shumë palë interesi (Treguesi: Cilësia dhe efektshmëria e rrjeteve).
- Zvicra do të bashkëdrejtojë grupin tematik të punës për AFP-në dhe do të mbështesë bashkërendimin qeveri-donatorë që jep kontribut për reformat. (Treguesi: Niveli i njohjes nga homologët, që Zvicra është burim i besueshëm në kuadër të reformave të AFP-së).
- Mesazhet e politikave për zhvillimin ekonomik dhe punësimin do të përditësohen vazhdimisht me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të kontekstit dhe do t'i komunikohen përkatësisht audiencave të synuara.

## Shërbimet infrastrukturore dhe ndryshimet klimatike (SECO)

**Rezultati 3 i Portofolit Zviceran:** Njerëzit përfitojnë nga qasja e përmirësuar në shërbime të qëndrueshme të infrastrukturës ekonomike dhe nga trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj

| | |
|---|---|
| *Jep kontribut për:* | **Nën-objektivin Nr. 3:** *Trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj;*<br>**Nën-objektivin Nr. 6:** *Parandalimi i fatkeqësive dhe garantimi i rindërtimit dhe rehabilitimit;*<br>**Nën-objektivin Nr. 7:** *Forcimi i qasjes sipas nevojës në shërbime bazë me cilësi të lartë.* |

| **(1) Rezultatet e Portofolit Zviceran** | **(2) Kontributi i Programit Zviceran** | **(3) Rezultatet e Zhvillimit të Vendit** |
|---|---|---|
| **Deklarata e rezultatit 1:**<br>Populli përfiton nga shërbime të besueshme dhe të përballueshme të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura[14] dhe mbetjeve të ngurta[15] të ofruara nga institucione të efektshme publike.<br><br>**Treguesit:**<br>1) Numri i personave me qasje në shërbime publike infrastrukturore më të mira (SECO SI 8)<br>a) sektori i ujit<br>Baza fillestare (2021): 600.000<br>Synimi (2025): 1.000.000<br>b) sektori i mbetjeve të ngurta<br>Baza fillestare (2021): 185.000<br>Synimi (2025): 800.000 (për t'u vendosur)<br><br>2) Masa për përmirësimin e kapaciteteve/aftësive institucionale dhe profesionale (SECO SI 4)<br>a) performanca financiare e ndërmarrjeve të ujësjellësit kanalizimeve<br>Baza fillestare (2021): 78% e kostove mbulohen (për operim dhe mirëmbajtje) për ujësjellësin dhe ujërat e ndotura<br>Synimi (2025): 90% e kostove mbulohen (për operim dhe mirëmbajtje) për 7 ndërmarrje publike të ujësjellës kanalizimeve<br>b) sektori i mbetjeve të ngurta<br>Baza fillestare (2021): 22 bashki[13], miratojnë planet vendore, burimet financiare dhe njerëzore për menaxhimin e mbetjeve<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar | Zvicra jep kontribut për forcimin e institucioneve dhe për mëkimin e transformimit digjital përmes ngritjes së kapaciteteve dhe investimeve të synuara që shërbejnë si katalizatorë në lidhje me aftësinë ripërtëritëse lidhur me klimën, infrastrukturën/pajisjet me nivele të ulëta karboni.<br><br>**Supozimet:**<br>• Partnerët e projektit në nivel qendror dhe vendor tregojnë nivel të lartë angazhimi dhe lidershipi për zbatimin e politikave, kuadrit ligjor dhe reformave institucionale në sektorët e ujësjellësit dhe menaxhimit të mbetjeve.<br>• Ndërmarrjet publike partnere arrijnë pikësynimet e parashikuara të performancës dhe përmirësojnë ofrimin e shërbimeve infrastrukturore për të gjithë qytetarët.<br><br>**Risqet:**<br>• Bashkitë nuk kanë vullnet të mjaftueshëm dhe qeveria qendrore nuk ka shtysat efikase për të mbështetur reformat për bashkimin e ndërmarrjeve publike.<br>• Ka ndërhyrje politike lidhur me emërimin e stafit drejtues në institucionet dhe ndërmarrjet publike.<br>• Qeveria qendrore nuk i siguron bashkive mbështetje të përshtatshme financiare për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal. | **Deklarata e rezultatit 1:**<br>Një pjesë gjithnjë e më e madhe e popullsisë shqiptare ka shërbime të sigurta të besueshme dhe me cilësi të lartë të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta.<br><br>**Treguesit:**<br>1) % e popullatës mbuluar me qasje të përmirësuar në shërbime të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta<br>a) sektori i ujit<br>Baza fillestare (2021): 80% (ujë)/ 56,7% (ujëra të ndotura) e popullatës e mbuluar me shërbim<br>Synimi (2025): 81,4%/60,9%<br>b) sektori i mbetjeve të ngurta<br>Baza fillestare (2021): 70% e popullatës e mbuluar me mbledhje të mbetjeve<br>Synimi (2025): Mbulim 90%<br><br>2) Efikasitet dhe cilësi e përmirësuar e shërbimeve të ujësjellës dhe kanalizimeve të ofruara nga institucionet publike<br>a) performanca financiare e ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve<br>Baza fillestare (2021): 75 % e kostove mbulohen (për operim dhe mirëmbajtje) për ujësjellësin dhe kanalizimet<br>Synimi (2027): 100% e kostove mbulohen (për operimin dhe mirëmbajtjen e 20 ndërmarrjeve publike)<br>b) sektori i mbetjeve të ngurta: Nr. i shërbimeve të përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve që përmbushin parimet kyçe dhe kërkesat ligjore për planifikimin<br>Baza fillestare (2021) 15 bashki zbatojnë plane të miratuara për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të harmonizuara me kuadrin strategjik të politikave<br>Synimi (2025): 30 bashki zbatojnë këtë lloj plani |

13 Tetëmbëdhjetë bashki janë mbështetur nga projekti i SDC-së për BtF dhe katër bashki në qarkun e Beratit janë mbështetur nga SECO.
14 Burimi: Strategjia Kombëtare për Ujësjellësit dhe Kanalizimet, 2019–2030.
15 Burimi: Strategjia dhe Plan Veprimi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035.

**Deklarata e rezultatit 2:**
Autoritetet kombëtare dhe vendore menaxhojnë energjinë në mënyrë të qëndrueshme me qëllim zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe mbështesin qytetet dhe komunitetet të kenë aftësi më të mira ripërtëritëse ndaj rreziqeve natyrore.

**Treguesit:**[16]
1) Numri i masave që mbështesin kuadrin ligjor për energjinë dhe ndryshimet klimatike dhe zbatimi i tyre
Baza fillestare (2021): 0
Synimi (2025): për t'u përcaktuar në 2022

2) Reduktimi i shkarkimeve të gazrave serrë në Mt CO2eq dhe kWh të kursyera/prodhuara nga energjitë e rinovueshme (SECO SI 10 dhe 11)
Baza fillestare (2021): 0
Synimi (2025): Mt CO2eq të kursyera gjatë jetëgjatësisë së zbatimit të masave (ndaj përdorimit faktik të karburanteve fosile) (për t'u përcaktuar në 2022)

3) Numri i qyteteve me masa për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe numri i banorëve apo shoqërive përfituese (SECO SI 7)
Baza fillestare (2021): 0
Synimi (2025): për t'u përcaktuar

Zvicra jep kontribut për përmirësimin e menaxhimit të energjisë dhe kuadrin e ndryshimeve klimatike dhe siguron prova kyçe për debatin e energjisë, duke zbatuar masa pilote për efiçencën e energjisë në bashki të përzgjedhura.

**Supozimet:**
- QSH, institucionet publike dhe bashkitë partnere janë të angazhuara të sigurojnë menaxhim të qëndrueshëm të energjisë, mbrojtje mjedisore dhe veprime klimatike për popullsinë.

**Risqet:**
- Bashkive u mungojnë mekanizmat financiarë për zbatimin e projekteve të infrastrukturës me efiçencë energjie dhe planet e veprimit për ndryshimet klimatike.
- Institucionet publike dhe bashkitë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme njerëzore të përkushtuara për ndryshimet klimatike.

**Deklarata e rezultatit 2:**
Zhvillohen burimet e brendshme energjetike, që sjellin një sistem energjetik rajonal, të integruar dhe të diversifikuar, i cili garanton sigurinë e furnizimit, mbrojtjen mjedisore dhe veprimet për klimën.

**Treguesit:**
1) Masat për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim sigurimin e aftësisë ripërtëritëse të sektorit të energjisë lidhur me klimën[17]
Baza fillestare (2021)[18]: 0
Synimi (2025): 10

2) CO2 dhe GS-të si reduktim në përqindje ndaj bazës fillestare dhe synimit të efiçencës së energjisë (EE) në %, dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë (RES) në %
Baza fillestare (2021): CO2 0/GS 0 & EE 6.8%/RES 38%
Synimi (2025): CO2 5,75%/GS 28% & EE 10%/RES 40.5%

3) Numri i bashkive me kapacitet për të hartuar plane vendore për përshtatjen me ndryshimet klimatike
Baza fillestare 2021[19]: 0
Synimi (2025): Janë vënë në zbatim 10 veprime pilot që synojnë të përforcojnë aftësinë ripërtëritëse ndaj klimës për 12 bashki

**(4) Linjat e veprimtarisë (Programi Zviceran)**

**Teoria e ndryshimit:**
**Nëse** ofruesit e shërbimeve infrastrukturore publike përmirësojnë kapacitetet e tyre dhe nëse partnerët e Zvicrës në vend menaxhojnë energjinë dhe burimet natyrore në mënyrë më të qëndrueshme, **atëherë** institucionet publike do të jenë më efektive, aftësia ripërtëritëse e vendit ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore do të përforcohet dhe njerëzit dhe bizneset do të përfitojnë nga shërbime të përmirësuara, **sepse** Shqipëria është e angazhuar për tranzicionin e energjisë, mbrojtjen mjedisore dhe zhvillimin e burimeve vendase të qëndrueshme të energjisë.

- Trajtohet dhe jepet kontribut për çështjet themelore të reformave që lidhen e qeverisjen e korporatave, sistemin e tarifave, financimin dhe qëndrueshmërinë në sektorët e ujit, mbetjeve dhe energjisë, ndërkohë që ndërmerret angazhim në dialogun e politikave për sjelljen e ndryshimeve sistemike në kuadrin e politikave dhe atë rregullator në këta sektorë.
- Sigurohet forcim institucional/zhvillim korporatash për institucionet publike dhe organizatat profesionale joqeveritare në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, që sjell performancë të përmirësuar financiare/operacionale (përfshirë masat e integritetit) dhe ofrim më të mirë shërbimesh në sektorët e ujit, mbetjeve të ngurta dhe energjisë.
- Mbështetet qeveria qendrore dhe njësitë vendore për menaxhimin e burimeve natyrore në një mënyrë të qëndrueshme dhe efektive; veçanërisht (i) duke paraqitur sisteme të menaxhimit të energjisë në bashki pilote; (ii) duke diversifikuar furnizimin me energji nga burime të rinovueshme përmes ankandeve të energjisë; dhe (iii) duke lehtësuar vlerësimin e qëndrueshmërisë së energjisë hidrike, të cilët janë të gjithë hapa të rëndësishëm drejt zbutjes së ndryshimeve klimatike.
- Jepet kontribut për zbatimin e masave të pakësimit të ndryshimeve klimatike dhe riskut nga fatkeqësitë (DDR) në të gjitha nivelet, në përputhje me Kuadrin Sendai të OKB-së, direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

**(5) Burimet dhe partneritetet (Programi Zviceran):**
Buxheti: 18,5 milion CHF (SECO 18,5 milion CHF)

**Partnerët:** Homologët kryesorë kombëtarë janë Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare për Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta, Agjencia për Efiçencën e Energjisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, autoritetet rregullatore, bashkitë, ndërmarrjet publike dhe OSHC-të. Partnerët kryesorë zbatues janë organizata ndërkombëtare dhe kombëtare si KfW, BB dhe BERZH (që krijojnë sinergji dhe sigurojnë efikasitetin e duhur midis donatorëve/financuesve që punojnë në të njëjtat fusha) dhe firma private konsultimi.

16 Një nëngrup të dhënash për këta tregues do të sigurojnë informacion për SDC CCE_ARI_1 (Numri i personave që përfitojnë nga masa konkrete për përshtatjen me ndryshimet klimatike), duke qenë se ndryshimet klimatike janë një temë ndërsektoriale
17 Strategjia e Energjisë së Shqipërisë 2019–30.
18 Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2021-2024, Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2021-2025.
19 Strategjia dhe Plani Kombëtar për Ndryshimet Klimatike 2019-2030.

| (6) Rezultatet e menaxhimit/performancës, përfshirë treguesit (Programi Zviceran) |
|---|
| • Modalitetet e bazuara në performancë po integrohen gjithnjë e më shumë në projektet publike dhe të mbështetura nga donatorët (Treguesi: Niveli i integrimit të modaliteteve të bazuara në performancë).<br>• Ndërhyrjet me shumë partnerë për rritjen e bashkërendimit dhe për të përdorur dhe mbështetur reformën në sektor (Treguesi: Cilësia e ndërhyrjeve me shumë partnerë).<br>• Përqendrimi është tek përgatitja e 'projekteve' për mobilizimin e burimeve vendase/të jashtme dhe/ose mundësimin e qasjes në mekanizma të brendshëm/të jashtëm financimi.<br>• Mesazhet e politikave për infrastrukturën dhe ndryshimet klimatike do të përditësohen vazhdimisht me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të kontekstit dhe do t'i komunikohen përkatësisht audiencave të synuara. |

## Shëndetësia (SDC)

**Rezultati 4 i Portofolit Zviceran:** Qytetarët e fuqizuar kanë qasje sipas nevojës në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë.

| | |
|---|---|
| *Jep kontribut për:* | **Nën-objektivin nr. 7:** *Forcimi i qasjes sipas nevojës në shërbime bazë me cilësi të lartë;*<br>**Nën-objektivin Nr. 10:** *Promovimi i qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit dhe forcimi i shoqërisë civile* |

| (1) Rezultatet e Portofolit Zviceran | (2) Kontributi i Programit Zviceran | (3) Rezultatet e Zhvillimit të Vendit |
|---|---|---|
| **Deklarata e rezultatit 1:**<br><br>Njerëzit fillojnë të bëjnë një stil më të shëndetshëm jetese në një mjedis që mëkon shëndetin.<br><br>Treguesit:<br><br>1) Numri i njerëzve të përfshirë përmes sesioneve të edukimit për shëndetësinë lidhur me parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme (HLT ARI 2), të kategorizuara sipas gjinisë dhe LNOB-së<br><br>Baza fillestare (2021): 104.000 (51% F) 31.000 (51% F) LNOB<br>Synimi (2025): 900.000 (51%) 100.000 (51% F) LNOB<br><br>2) Edukimi për shëndetin: Niveli i ndërgjegjes tek fëmijët dhe adoleshentët lidhur me faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në shëndetin e tyre (përfshirë shëndetin riprodhues dhe mjedisin)<br><br>Baza fillestare (2021): për t'u vendosur në 2022<br>Synimi (2025): për t'u vendosur në 2022 (+10% mbi bazën fillestare) | Zvicra jep kontribut për shëndetin publik përmes ndërgjegjësimit lidhur me sjelljet e shëndetshme, veçanërisht tek fëmijët dhe adoleshentët, duke promovuar modele të thjeshta dhe të përballueshme të promovimit të shëndetit në nivel vendor dhe duke mbështetur krijimin e një kuadri rregullator për promovimin e stileve të shëndetshme të jetës.<br><br>Supozimet:<br>• QSH zbaton një qasje shumësektoriale për zbatimin e strategjisë kombëtare për shëndetin dhe planin kombëtar të veprimit për promovimin e shëndetit, e mbështetur nga burime të përkushtuara financiare.<br><br>• Bashkitë tregojnë interes gjithnjë e më të madh dhe luajnë një rol gjithnjë e më të madh në veprimtaritë e shëndetit publik në territorin e tyre.<br><br>• Investimet në edukimin shëndetësor janë një parakusht për angazhimin e qytetarëve dhe OSHC-ve në politikat e shëndetit.<br><br>Risqet:<br>• Qeveria qendrore dhe njësitë vendore nuk janë të gatshme të caktojnë më shumë burime njerëzore dhe financiare për veprimet e promovimit të shëndetit në nivel qendror dhe vendor.<br><br>• Industritë e ushqimit/pijeve/duhanit ushtrojnë trysni mbi QSH-në, duke penguar krijimin e një kuadri që mëkon shëndetin e mirë. | **Deklarata e rezultatit 1:**<br><br>Promovohen stilet e shëndetshme të jetesës dhe mundësohen zgjedhjet e shëndetshme (Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030).<br><br>Treguesi:<br><br>1) Përllogaritje e prevalencës për tregues të përzgjedhur shëndetësorë<br>a) Prevalenca e duhanpirjes<br>Baza fillestare (2021): 45% M, 7% F në moshë madhore<br>80% e fëmijëve nuk pinë duhan<br>Synimi (2025): 40%M, 4%F në moshë madhore<br>90% e fëmijëve nuk pinë duhan<br>b) Konsumi i alkoolit<br>Baza fillestare (2021): 20%M, 3% F (konsumojnë çdo javë), 80% e fëmijëve nuk konsumojnë alkool<br>Synimi (2025): 18%M, 1% F (konsumojnë çdo javë), 90% e fëmijëve nuk konsumojnë alkool<br>c) Prevalenca e mbipeshës dhe obezitetit<br>Baza fillestare (2021): 53%M, 43%F në moshë madhore, 20% e fëmijëve<br>Synimi (2025): 50%M, 40%F në moshë madhore, 17% e fëmijëve |

| | | |
|---|---|---|
| **Deklarata e rezultatit 2:**<br>Sistemi shëndetësor siguron qasje të përmirësuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor me aftësi të përmirësuara përtëritëse dhe përgatitje në raste emergjencash<br><br>**Treguesit:**<br><br>1) Përqindja e pacientëve të kënaqur me ofrimin e shërbimeve nga institucionet shëndetësore (HLT TRI 3 të kategorizuar sipas gjinisë dhe LNOB)<br><br>Baza fillestare (2021): 68% (Dibër dhe Fier) (57%F) në Nivel Kombëtar: për t'u përcaktuar në 2021<br>Synimi (2025): 80% (51%F) (Dibër dhe Fier), në Nivel Kombëtar: 55% - (51%F), LNOB 50% (51%F)<br><br>2) e njësive të KSHP-së ofrojnë shërbime urgjence me cilësi të lartë dhe kryejnë mbikëqyrje me cilësi të mirë<br><br>Baza fillestare (2021): për t'u përcaktuar në 2022<br>Synimi (2025): për t'u përcaktuar në 2022 (+20% e bazës fillestare) | Zvicra jep kontribut për efikasitetin, mbulimin dhe përfshirjen në shërbime të kujdesit shëndetësor, përfshirë për rastet e urgjencës dhe veçanërisht për grupet më të cënueshme. Ajo mbështet gjithashtu aktorë të tjerë të sistemit, si OSHC-të, me qëllim arritjen e një përgjigje më të mirë ndaj emergjencave shëndetësore. Zvicra jep kontribut për hartimin e politikave të qarta për burimet njerëzore dhe për angazhimin me diasporën, si dhe për zhvillimin e mundësive digjitale për shëndetin.<br><br>Gjithashtu, Zvicra mbështet hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave shëndetësore kombëtare me pjesëmarrje, promovimin e angazhimit të qytetarëve dhe shoqërisë së organizuar civile, si dhe të sektorit privat vendor dhe kombëtar.<br><br>**Supozimet:**<br>• QSH çon përpara transformimin e KSHP-së duke rritur qasjen në kujdes të cilësisë së lartë.<br>• Qytetarët dhe OSHC-të angazhohen aktivisht në kujdesin shëndetësor dhe ndikojnë në politikat e shëndetësisë, duke rritur besimin dhe transparencën në sektorin e shëndetësisë. QSH kupton dhe promovon rolin aktiv të OSH-ve në shëndetësi.<br>• Institucionet publike kombëtare veprojnë si shtysa të ndryshimit me qëllim ofrimin e shërbimeve të decentralizuara, bashkërenduara dhe përfshirëse shëndetësore, veçanërisht në raste emergjencash.<br>• Bashkërendimi i mbështetjes së jashtme në sektor është funksional.<br><br>**Risqet**<br>• Zbatimi i strategjisë së KSHP-së përparon me ngadalë.<br>• Një pjesë gjithmonë e më e vogël e buxhetit të shëndetësisë i caktohet KSHP-së.<br>• Emigracioni i fuqisë punëtore me aftësi nuk trajtohet nga një strategji e përshtatshme për fuqinë punëtore në shëndetësi.<br>• Vijon menaxhimi i centralizuar i sistemit të shëndetësisë.<br>• Shërbimet e KSHP-së nuk ndërmarrin kujdesin në rastet e urgjencave dhe nuk pranohen si aktorë të rëndësishëm nga QSH. | **Deklarata e rezultatit 2:**<br>Shërbimet e KSHP-së përshtaten për nevojat e popullsisë, bazuar në analizat demografike, epidemiologjike dhe shoqërore. Forcohet roli i KSHP-së në shërbimin e urgjencës. (Strategjia Kombëtare për Shëndetin 2021-2030).<br><br>**Treguesit:**<br><br>1) Programi Kombëtar i Kontrollit Mjekësor Bazë zbatohet për popullsinë e grupmoshës 35 deri 70 vjeç<br><br>Baza fillestare (2021): 80%<br>Synimi (2025): 100%<br><br>2) Zbatohen modelet e integruara (modeli i kujdesit në banesë dhe ai social-shëndetësor) të KSHP-së<br><br>Baza fillestare (2021): 2 qarqe<br>Synimi (2025): 6 qarqe<br><br>3) Përparohet drejt një politike dhe kuadri rregullator kombëtar që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve shëndetësore vendore dhe qendrore dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në raste emergjencash<br><br>Baza fillestare (2021): Mungesa e përkufizimit<br>Synimi (2025): Përkufizim më i mirë |

**(4) Linjat e veprimtarisë (Programi Zviceran)**

**Teoria e ndryshimit:**
**Nëse** të gjithë qytetarët (përfshirë grupet e cënueshme) përvetësojnë sjellje më të shëndetshme, angazhohen në kujdesin e tyre shëndetësor dhe kërkojnë qasje në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë, **atëherë** sistemi i kujdesit shëndetësor parësor, përfshirë kujdesin e urgjencës, do t'i përshtaten nevojave të popullsisë dhe shëndeti i qytetarëve do të përmirësohet, **sepse** një qasje llogaridhënëse, e decentralizuar dhe bazuar në OSHC i përgjigjet me efektshmëri nevojave të shëndetit të qytetarëve.

- Vijohet dialogu i rregullt dhe efikas i politikave për çështje madhore strukturore dhe të sistemit lidhur si me rezultatet, ashtu edhe me sektorin e shëndetësisë në përgjithësi.
- Fuqizohet bashkërendimi dhe harmonizimi i donatorëve.
- Përmirësohet efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve të KSHP-së përmes përmirësimit të kapaciteteve drejtuese dhe ristrukturimit.
- Mbështetet zhvillimi i kapaciteteve të organizatës dhe atyre individuale.
- Ndikohen politikat për strukturën, standardet, protokollet e KSHP-së.
- Përmirësohet qeverisja, transparenca, llogaridhënia dhe masat antikorrupsion (p.sh. në institucione shëndetësore).
- Fuqizohen OSHC-të dhe mbështeten platformat e advokimit, dhe forcohen aktorët joshtetërorë.
- Riorganizohen shërbimet shëndetësore dhe puna në ekip, përfshirë sistemin e referimit.
- Mëkohet bashkëpunimi ndërsektorial, veçanërisht ndërmjet sektorit shëndetësor dhe atij shoqëror dhe ndërmjet institucioneve shëndetësore dhe autoriteteve vendore.
- Mbështeten veprimtaritë për ndryshimin e sjelljes duke përfshirë komunitetin, shkollat dhe institucione të tjera.
- Mbështeten veprimtari për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Përmirësohen shërbimet për të administruar dhe kontrolluar më mirë sëmundjet jo të transmetueshme

**(5) Burimet dhe partneritetet**
Buxheti: 11,55 milion CHF (SDC 11,55 milion CHF)

**Partnerët:** Partnerët kryesorë do të jenë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Partneriteti me ISHP-në do të zgjerohet në të gjithë vendin dhe do t'i kushtohet më shumë vëmendje bashkëpunimit me bashkitë. OBSH, BB, UNFPA, UNICEF, BE. Mbështetja për OSHC-të do të shtohet.

Sa i përket modaliteteve, do të merren në konsideratë kontribute të drejtpërdrejta për institucionet publike, bazuar në mundësi, dhe në varësi të angazhimit financiar të partnerit përkatës. Do të punohet aktivisht për kontribute themelore për OSHC-të kyçe në sektor. Duhet të kryhet edhe bashkëfinancimi me organizata shumëpalëshe (veçanërisht OBSH). Zvicra do të vijojë përpjekjet e saj për bashkërendimin e donatorëve si bashkëdrejtuese (me OBSH-në) e grupit të punës për shëndetësinë. Do të thellohet nxitja e bashkëpunimit trepalësh (Shqipëri, Greqi, Zvicër), bazuar në kërkesë dhe në mundësi.

**(6) Rezultatet e menaxhimit/performancës**
Duke qenë se ndërhyrja për urgjencën nuk është përkufizuar ende, treguesit mund të duhet të rishikohen në vitin 2022

- Mbështetja për OSHC-të do të marrë vëmendje më të madhe dhe do të jetë më strategjike, duke shkuar përtej veprimeve të vogla.
- Do të ndërmerren veprime të përbashkëta me OBSH-në dhe donatorë të tjerë për dialogun e politikave.
- Sinergjitë ndërmjet forcimit të KSHP-së, kujdesit të urgjencës dhe parandalimit të sëmundjeve jo të transmetueshme do të forcohen përmes një qasje lidhëse (HA-Zhvillim).
- Vlerësim sasior i përparësive strategjike:
    - Niveli i mbështetjes për OSHC-të dhe disa OSHC të angazhuara përtej veprimeve të vogla
    - Angazhimi i donatorëve të tjerë
- Mesazhet e politikave për shëndetësinë do të përditësohen vazhdimisht për të pasqyruar ndryshimet e kontekstit dhe do t'i komunikohen përkatësisht audiencës së synuar.

# Shtojca 3: Sistemi i monitorimit

Sistemi i monitorimit të Programit të Bashkëpunimit Zviceran 2022-25 mbështet nxjerrjen e mësimeve nga vendimmarrja si në nivel programi dhe atë të projekteve individuale, ndërkohë që përdoret për llogaridhënie dhe komunikim. Sistemi përfshin katër nivele vëzhgimi dhe mbështetet në një sërë instrumentesh që përdoren në mënyrë të vijueshme dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Të dhënat dhe informacioni që mblidhen përbëjnë bazën për përshtatjen dhe rregullimin e programit me zhvillimet në kontekst dhe për të ndikuar politikat në nivel politik. Katër nivelet e vëzhgimit janë: i) konteksti, ii) rezultatet e Portofolit Zviceran (efikasiteti), iii) zhvillimi i vendit (efikasiteti) dhe iv) menaxhimi i programit.

Monitorimi i kontekstit të vendit përfshin zhvillimin politik, shoqëror, ekonomik dhe mjedisor të Shqipërisë dhe efektet e tij në Portofolin Zviceran.

Monitorimi i Kuadrit Zviceran të Rezultateve vlerëson progresin për arritjen e rezultateve të pritshme nga ndërhyrjet zvicerane si kontribut për arritjen e objektivave të politikave dhe programeve kombëtare, përfshirë temat transversale. Monitorimi i zhvillimeve në vend vlerëson progresin e vendit në zbatimin e përparësive kombëtare, bazuar në statistikat kombëtare, raportet e monitorimit të vendit kur këto të fundit janë të disponueshme, dhe vlerësimet e kryera nga partnerët për zhvillim. Monitorimi i menaxhimit të programit përqendrohet në efikasitetin dhe efektshmërinë e punës së ambasadës së Zvicrës, arritjen e rezultateve të menaxhimit (RF, fusha 6) dhe përputhjen me parimet e menaxhimit dhe ndihmës (kreu 6).

| Dimensioni | Fushat e vëzhgimit | Instrumentet | Shpeshtia kohore |
|---|---|---|---|
| Konteksti i vendit | • Prirjet e përgjithshme politike dhe social-ekonomike<br>• Zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale<br>• Risqet<br>• Rezultatet e zhvillimit të vendit | • MERV<br>• Shkëmbime të rregullta të ekipit<br>• Analiza dhe raportime për ndryshimet e rëndësishme të kontekstit<br>• Shkëmbime të rregullta me donatorët e tjerë dhe ekspertët; marrëdhënie dhe shkëmbime diplomatike<br>• Raport Vjetor | • Shtator<br>• Javor<br>• Sipas rastit |
| Portofoli Zviceran | • Rezultatet e programit zviceran, kontributi për dhe progresi drejt rezultateve të vendit<br>• Ndryshime në temat ndërsektoriale (barazia gjinore dhe qeverisja e mirë) | • Vlerësimi gjashtëmujor<br>• Raport Vjetor<br>• Në nivel projekti:<br>- Mbledhjet e komitetit drejtues<br>- Vlerësimi i riskut të partnerëve<br>- Vizita monitorimi në terren | • Maj<br>• Tetor |
| Drejtuesit | • Efikasiteti dhe përputhshmëria e Ambasadës | • Planifikimi operacional<br>• Raport Vjetor<br>• Raport i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm<br>• Plan i Sigurisë Vendore | • Januar<br>• Tetor<br>• Shtator<br>• Çdo vit |

# Shtojca 4: Planifikimi Financiar (në CHF)

| **Programi i Bashkëpunimit Zviceran për Vendin/Rajonin: Shqipëri** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kohëzgjatja e Programit për Bashkëpunim: Janar 2022 deri në Dhjetor 2025 | | | | | | | |
| | **SDC** | | | | **SECO** | | |
| Viti financiar | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2022–25 | Total 2022–25 | in % |
| Detajimi i alokimit të buxhetit sipas Fushës së ndërhyrjes/Rezultatet e portofolit | | | | | | | |
| Fusha e ndërhyrjes/Rezultati i portofolit 1 | | | | | | | |
| **Qeverisja demokratike** | **7’800’000** | **8’500’000** | **8’500’000** | **8’000’000** | **4’000’000** | **36’800’000** | **36%** |
| Fusha e ndërhyrjes/Rezultati i portofolit 2 | | | | | | | |
| **Zhvillimi ekonomik dhe punësimi** | **5’500’000** | **4’100’000** | **4’300’000** | **3’700’000** | **17’500’000** | **35’100’000** | **34%** |
| Fusha e ndërhyrjes/Rezultati i portofolit 3 | | | | | | | |
| **Shërbimi i infrastrukturës dhe ndryshimet klimatike** | | | | | **18’500’000** | **18’500’000** | **18%** |
| Fusha e ndërhyrjes/Rezultati i portofolit 4 | | | | | | | |
| **Shëndetësia** | **2’450’000** | **3’000’000** | **2’500’000** | **3’600’000** | **-** | **11’550’000** | **11%** |
| Rezultate të tjera | | | | | | | |
| **Aksione të vogla** | **250’000** | **200’000** | **500’000** | **500’000** | **-** | **1’450’000** | **1%** |
| **Alokimi i përgjithshëm i buxhetit (për Zyrën(at) e Bashkëpunimit Ndërk.)** | **16’000’000** | **15’800’000** | **15’800’000** | **15’800’000** | **40’000’000** | **103’400’000** | **100%** |

| Vështrim i përgjithshëm i alokimit indikativ të buxhetit nga Zyrat Federale Zvicerane (vetëm për qëllime informimi):[1] | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Buxheti i alokuar për Zyrën(at) BN** | **16’000’000** | **15’800’000** | **15’800’000** | **15’800’000** | **40’000’000** | **103’400’000** |
| prej kësaj: SDC-Bashkëpunimi Lindor | 16’000’000 | 15’800’000 | 15’800’000 | 15’800’000 | | 63’400’000 |
| SECO - Bashkëpunimi Ekonomik [2] | | | | | 40’000’000 | 40’000’000 |
| *SDC - Partneritetet Institucionale* | 430’000 | 432’000 | 432’000 | 431’000 | | 602’000 |
| **Alokimi i përgjithshëm i buxhetit nga zyrat federale** | **16’430’000** | **16’232’000** | **16’232’000** | **16’231’000** | **40’000’000** | **105’125’000** |

Për më tepër, Shqipëria përfiton nga programet rajonale të Departamentit të Bashkëpunimit Botëror të SDC-së të drejtuar nga Divizioni i Ndryshimeve Klimatike dhe Mjedisit dhe nga Divizioni i Migracionit dhe Zhvillimit.
Shpërndarja përfundimtare e fondeve do të varet nga identifikimi i ndërhyrjeve të përshtatshme, kapaciteti përthithës, si dhe nga efikasiteti dhe efektshmëria e bashkëpunimit me partnerët përkatës në vend. Në këtë kuadër, informacioni i buxhetit të planifikuar për periudhën katër vjeçare është vetëm paraprak. Informacioni shërben vetëm si bazë për planet e shpenzimit në të ardhmen, të cilat shqyrtohen çdo vit nga Parlamenti Zviceran.

# Shtojca 5: Shkurtesat

| | |
|---|---|
| 2tCO2eq | Shkarkime të nevojshme për jetesën të caktuara për çdo individ të varfër |
| ADA | Agjencia Austriake për Zhvillim |
| AFP | Arsimi dhe Formimi Profesional |
| AR/AP | Raport Vjetor/Program Vjetor |
| ARI | Treguesi Agregat i Referencës |
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BERZH | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim |
| CHF | Franga Zvicerane |
| DBE | Delegacioni i Bashkimit Evropian |
| EURO | Euro |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| GIZ | Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| IFC | Korporata Financiare Ndërkombëtare |
| IHD | Investime të Huaja Direkte |
| INSTAT | Instituti Shqiptar i Statistikave |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| KESH | Korporata Elektroenergjetike Shqiptare |
| KSHP | Kujdesi shëndetësor parësor |
| KfW | Kreditanstalt für Wiederaufbau/Banka Gjermane për Zhvillim |
| KiE | Këshilli i Evropës |
| LFS | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| LNOB | Askush të mos mbetet pas |
| MERV | Sistem Monitorimi për Ndryshimet e Lidhura me Zhvillimin |
| MFP | Menaxhimi i financave publike |
| MR | Përgjigje nga Menaxhmenti |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MYR | Vlerësimi Gjashtëmujor |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut |
| NEET | Të papërfshirë në arsim, punësim, ose formim |
| NPL | Hua e keqe |
| NjQV | Njësi e Qeverisjes Vendore |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetit |
| ODA | Ndihmë zyrtare për zhvillim |
| ODIHR | Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |

| | |
|---|---|
| OJQ | Organizatë Jofitimprurëse |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| OOP | Pagesa nga xhepi |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| OSHC | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| PBB | Prodhimi i Brendshëm Bruto |
| PEFA | Shpenzimet publike dhe llogaridhënia financiare |
| QSH | Qeveria Shqiptare |
| RPU | Rishikimi Periodik Universal |
| RRF | Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë |
| SDC | Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim |
| SECO | Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |
| SI | Tregues Standard |
| SIDA | Agjencia Suedeze për Bashkëpunim në Zhvillimin Ndërkombëtar |
| SJT | Sëmundjet Jo të Transmetueshme |
| SKZHI | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim |
| SWISSA | Dhoma Zvicerano-Shqiptare e Tregtisë |
| SZHBI | Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve |
| TADAT | Mjet i Vlerësimit Diagnostik të Administrimit të Taksave |
| TAP | Gazsjellësi Trans Adriatik |
| TRI | Tregues Tematik Reference |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |
| USD | Dollar Amerikan |
| WEF | Forumi Ekonomik Botëror |

# Shtojca 6: Hartë që tregon 12 qarqet e Shqipërisë



Imprint

Redaktues:
Departamenti Federal për Punët e Jashtme FDFA
**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**
3003 Bernë
www.sdc.admin.ch

Departamenti Federal për Çështjet Ekonomike, Arsimin dhe Kërkimin EAER
**Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO**
3003 Bernë
www.seco-cooperation.admin.ch

Design:
Joreld Dhamo

Fotografitë:
Albes Fusha, Gent Shkullaku, Florion Goga, Regional Cooperation Council RCC,
Bledar Hasimi, Bevis Fusha, Blerim Tuzi

Porosi:
FDFA Information
Tel. +41 (0)58 462 31 53
E-mail: publikationen@eda.admin.ch

Kontakt:
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Rr. Ibrahim Rugova 3/1
1019 Tirana, Albania
Tel. +355 4 225 65 35
tirana@eda.admin.ch

Ky publikim është i disponueshëm edhe në anglisht. Mund të shkarkohet nga:
www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/strategy.html

Bernë, mars 2022, © SDC